

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.5/6, Maj - Qershor 2018

SHËN AMBROZI I ALEKSANDRISË, TEOLOG DHE MËSUES NË ALEKSANDRI(+250)

Me 17 shkurt, Kisha e përkujton Shën Ambrozin e Aleksandrisë, ishte mik i teologut të krishterë Origjenit si edhe shoqërues i vazhdueshëm i tij. Ai u lind në shekullin e dytë në Aleksandri të Egjiptit. Ai u shugurua për diakon duke iu kushtuar Hyjit dhe popullit të Zotit. I kureshtuar për dijeni biblike i drejtohej Origjenit me pyetje të ndryshme dhe kërkoi atij për të shkruar komentet në librat e Biblës. Ai nga dashamirësia që kishte e furnizonte vazhdimisht Origjenin me literaturë biblike, që gjendeshin në bibliotekën e famshëm të Aleksandrisë gjatë vitit 212. Ia, për shkak të bindjes që kishte, se duhet besuar në një Zot të vetëm, vuajti persekutimin nën perandorin romak Maximinus Thrax gjatë vitit 235. Pas lirimit më vonë rreth vitit 250 vdiq. Përmendja e fundit e Ambrozitë është shënuar në librat e Origjenit, kundra Celsit (Contra Celsum), që janë shkruar në kërkesën e vet Ambrozitë.

Origjeni si dijetar i Kishës, shpesh flet për Ambrozinë si një njeri i arsimit me shije të shkëlqyer letrare dhe shkencore. Të gjitha veprat e Origjenit të shkruara pas vitit 218 janë të dedikuara miku të tij Ambrozitë. Letrat e Ambrozitë të cituara në veprat e Origjenit, janë vlerësuar shumë edhe nga Shën Jeronimi nga Stridoni (Spliti), përkthyes e parë i Biblës, nga aramenishtja dhe greqishtja në gjuhën latine në shek. IV. Shën Ambrozi nderohet si Shenjtë dhe teolog, si nga Kisha Kopte Ortodokse, nga Kisha Ortodokse Lindore, si edhe nga Kisha Katolike Romake. Kurs, festa liturgjike përkujtohet më 17 mars.





Papa Françesku KAROL VOJTLA	4
Dom Nosh Gjolaj GATISHMËRIA PËR T'U MËSUAR	6
Dom Lush Gjergji SHËN NËNË TEREZA	9
Don Giovani Kokona ETAPA POST-MARTIRE	13
Revista Avenire MËNJANOHEK KUSH NUK SHËRBEN	15
Revista Giovanni Columbu MBI MBRETIN	17
Revista Malësia KISHA 900-VJEÇARE E SHËN GJONIT	21
Prof. Georg Stadtmüller ISLAMIZIMI I SHQIPTARËVE	24
MESHA TRADICIONALE NË RRËNOJAT NË RRUSHKULL	27
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXI, nr. 5/6 (507-508) Maj - Qershor 2018

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA
Fotografe: Luli Ndreu

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

**PAPA FRANÇESKU:
“KAROL VOJTLA VAZHDON TË NA FRYMËZOJË”!**


I jam mirënjohës Polonisë për Gjon Palin II. Kështu pohon Papa Françesku në një videomesazh, transmetuar nga televizioni e radioja kombëtare polake, me rastin e shenjtërimit të Karol Vojtilës e të Anxhelo Ronkalit (Gjoni XXIII), të dielën, më 27 prill. Ati i Shenjtë vë në dukje “dëshminë e jashtëzakonshme të shenjtërisë” së Papës polak, duke i ftuar të gjithë të frymëzohen nga shembulli i tij. Jam i lumtur që po e shpall shenjtor Karol Vojtilën, njeri e Papë i madh, nënvizon Françesku në mesazh: “I jam mirënjohës Gjon Palit II, ashtu si të gjithë anëtarët e Popullit të Zotit, për shërbimin e tij të palodhur, për udhëheqjen e tij shpirtërore, për faktin se e ka çuar Kishën në udhën e mijëvjeçarit të tretë të fesë e për dëshminë e jashtëzakonshme të shenjtërisë”

Më pas, Papa Bergolio kujton homelinë e Benediktit XVI në ditën e lumnimit të Karol

Vojtilës. Gjon Pali II i pati kërkuar gjithë botës të mos ketë frikë e t'ia hapë portat Krishtit. Ai vetë, i pari, bëri ç'është e mundur për t'ia hapur Krishtit portat e shoqërisë, të kulturës dhe të sistemeve politike e ekonomike, duke kontribuar, me forcën e një gjiganti, në ndryshimin e kahes së historisë, e cila dukej e pakthyeshme: “Me dëshminë e tij të fesë, të dashurisë e me guximin apostolik, shoqëruar me një ngarkesë të madhe humane, ky bir shembullor i kombit polak i ndihmoi të krishterët e gjithë botës të mos kenë frikë ta quajnë veten ndjekës të Krishtit, të bëjnë pjesë në Kishë, të flasin për Ungjillin. Me një fjalë: na ndihmoi të mos kemi frikë nga e vërteta, sepse e vërteta është garanci e lirisë. (Homelia, 1 maj 2011). Identifikohem plotësisht me këto fjalë”.

Papa Françesku kujton edhe se Karol Vojtila është formuar si i krishterë, në Poloni. Aty është formuar zemra e tij, që më pas, mori përmasa universale, së pari, duke marrë pjesë në Koncilin II të Vatikanit, e pastaj, pas 16 tetorit 1978, si Papë, duke bërë ç'është e mundur që në këtë zemër të gjenin vend të gjitha kombet, gjuhët e kulturat: “Gjon Pali II u bë gjithçka për të gjithë. Falënderoj popullin polak dhe Kishën në Poloni për dhuratën e Gjon Palit II. Të gjithë jemi pasuruar nga kjo dhuratë. Gjon Pali II vazhdon të na frymëzojë. Na frymëzojnë fjalët, shkrimet, gjestet, mënyra e tij e shërbimit. Na frymëzon vuajtja e tij, jetuar me shpresë heroike. Na frymëzon lëshimi i tij i plotë në duart e Krishtit, Shëlbuesit të njeriut, dhe në ato të Nënës së Zotit”.

Gjatë vizitës së fundit “ad limina Apostolorum” të ipeshkvijve polakë, thotë në fund të mesazhit Papa Françesku, nënvizova se Kisha në Poloni vazhdon të ketë mundësi të mëdha feje, lutjeje, bamirësie e dashurie të krishterë. Shenjtërimi i Gjon Palit II dhe i Gjonit XXIII, uroi Ati i Shenjtë, qoftë nxitje për punën e kësaj Kise, të cilën Françesku do ta njohë më nga afër me rastin e Ditës Botërore të Rinisë, që do të mbahet në Krakov, në vitin 2016. E i kthehet së dielës



së shenjtërimit: “Shumë prej jush do të vinë në Romë, por falë mass media-ve, shumë të tjerë mund të marrin pjesë në këtë ngjarje të madhe. Prandaj, dua t’i falënderoj që sot, të gjithë gazetarët e shtypit, të radios e të televizionit për shërbimin e tyre me rastin e shenjtërimeve të 27 prillit. Përsëritës të gjithë bashkëkombasit e Gjon Palit II, edhe ata, që nuk i përkasin Kishës Katolike. I kam të gjithë në zemër. Zoti ju bekoftë të gjithëve!”

Zgjedhja e Karol Wojtilës në fronin e Shën Pjetrit/Dje, e lamë jetën e Papës Gjon Pali II në qershor të vitit 1978, kur populli polak ishte përfshirë nga protestat kundër komunizmit, që kardinali Wojtila i mbështeste me mish e shpirt. Pas pak javësh – informon gazetari italian Gian Franco Svidercoschi në librin-intervistë me kardinalin Stanislaw Xhivish, “Kam jetuar me një shenjt”, të cilin po e shfletojmë së bashku këto ditë, para shenjtërimit të Papës polak – vdiq Pali VI. E 33 ditë pas zgjedhjes, më 29 shtator, ndërroi jetë pa pritje edhe Gjon Pali I. Wojtila, si të gjithë kardinajtë, u kthye në Romë. “Shihej qartë, gjatë udhëtimit – thotë kardinali Xhivish, ish-sekretari personal i tij – se kishte diçka që e shqetësonte. Kësaj radhe, ishte më shumë i mbyllur në vetvete, në mendime, në lutje. Ishte e ditur se në Konklavin e mëparshëm kishte pasur një sërë votash për emrin e tij. ... Por ai nuk thoshte asgjë. E natyrisht, unë nuk e pyesja”. Ndodhi ashtu siç kishte frikë Karol Wojtila. Pas konfrontimit të

zgjedhur ndërmjet kryeipeshkvit të Firences, Giovanni Benelli dhe, kryeipeshkvit të Gjenovës, Giuseppe Siri, u venit mundësia për zgjedhjen e një italian. Kryeipeshkvi i Vienës, kardinali Franz Konig, filloi të kërkojë konsensus për kryeipeshkvin e Krakovit, që u zgjodh Papë gjatë votimit të tetë. Kardinajtë vunë gishtin mbi njeriun, i cili vinte “nga një vend i largët”, përtej perdes së hekurt. Ishte Papa i parë sllav, Papa i parë jo italian, pas gati 500 vjetësh. Kardinali Xhivish përshkruan në libër, emocionet e tij të asokohshme: “Isha në shesh, krah portës së Bazilikës së Vatikanit, kur dëgjova shqiptimin e emrit të tij nga kardinali Pericle Felici. Për një çast, pata frikë se po më dilte zemra nga krahërori. Bërtisja si i çmendur, por rreth meje bërtisnin të gjithë, nuk arrija ta dëgjoja veten. E përfytyrova të veshur me të bardha. Mendova për Poloninë time, sigurisht në festë, tronditur nga kjo e papritur. E, më vjen turp ta them, por kujtova me dashakeqësi fjalët e Sekretarit të parë të Partisë Komuniste të Silezisë, i cili, duke iu referuar faktit që kardinali Wojtila ishte nisur me pasaportë turistike, pasi ia kishin marrë atë diplomatike, më tha: “Shko, shko në Konklav, se kur të ktheheni do t’i bëjmë ne llogaritë me të”. Nëse do të kisha pasur mundësi, do t’i kisha çuar një telegram shokut sekretar: “Më vjen keq, por Provania Hyjnore kishte plane të tjera...”



Don NOSH GJOLAJ
Podgoricë

GATISHMËRIA PËR T'U MËSUAR PREJ TJETRIT

(Pjesa e dytë)

A) Përshtatja si e mashkullit ashtu edhe e femrës në jetën e përditshme

1) Në lemën sociale

Zakonisht në rrethin shoqëror, vajzat shumë më tepër dhe më shpjet kanë aftësi të klimatizohen (të përshtaten), po ashtu edhe më lehtë se meshkujt ato i përshtatën rrethit. Por, vajzat shumë pak kanë guxim dhe aftësi për të luftuar për një status të barabartë me bashkëshortin. Po ashtu do të ishte e gabuar dhe fatale, po qe se burri të kujdeset për ta zgjedh statusin e saj. Sepse, jeta e përbashkët martesore, nuk do të kishte më atë qëllimin e vet primar, aktualizimin e dy gjysmave, dhe fisnikërimin njëri ndaj tjetrit. Pastaj jeta e përbashkët martesore është edhe një lëmi e panjohur dhe e mbyllur në arkë, që e bren tija. Gjithashtu do të ishte për çdo burrë një tundim i madh, i cili do ta luajë rolin e mësuesit dhe të

E vetmja mënyrë e natyrshme është bashkësia martesore, e cila ka mundësia për ta realizuar qëllimin e jetës së përbashkët, pikërisht është ajo energjia e dashurisë që i lidhë dy individ - kuptohet në mënyrë të barabartë.

Roli i burrit nuk është të bëhet as mësues, as babë dhe njëherazi edhe bashkëshort, por ai duhet gjithherë dhe gjithkund të mbes bashkëshort dhe vetëm bashkëshort, i cili jep kurajë, trimëron, përkrah bashkëshorten duke ia shprehur dëshirat e veta personale, që e shoqëron me një mirëkuptim si dhe e qorton me vërejtje kritike. Por kjo vlen vetëm atëherë, kur gruaja ka ngel në errësirën e padituri së prej moshës së fëmijërisë, ose nuk ka pasur guxim t'i realizojë virtetet si dhe identitetin si femër, sepse rrethi tradicional (primitiv) nuk e ka lejuar që të zhvillohet në personin e pjekur. Zakonisht femrat e tilla ngelin jo vetëm nga aspekti afektiv dhe psikik, por edhe ngarkohet edhe me paragjykime e të së kaluarës.



bashkëshortit. Dhe si thotë ajo fjala e vjetër, "roli i pashës turk!" Një rrugë e tillë kuptohet se është e verbër (qorret) dhe shumë shpejt u hakmerret çiftit martesor. Sepse gjysma e individit mbetet e ndarë prej asaj gjysmës tjetër, në vend që të harmonizohen, të bashkohen si dhe të njësohen në njësi të përbashkët. Siç e kemi theksuar disa herë, duke ruajtur veten të pacenuar si dhe të tjetrit (partnerin) po ashtu nuk e shkel as nuk e pronëson tjetrin, por përkundrazi ia ruan dinjitetin e individit.

2) Aftësitë e meshkujve dhe femrave

Meshkujt në rastet e shumta janë të shkathtë për ta përdorur çekanin dhe daltën, por nuk kanë aftësi për solidaritetin në jetën e përbashkët martesore, si për shembull, ai nuk gjendet në shtëpinë e vet, po thuaj se është mysafir. Nuk i shkon përdore t'ia përgatis vetvetes një ushqim të ngrohtë, siç është

vetëm supa, edhe pse është mashkulli i njohur si kulinar, mjeshtër i kuzhinës me gjellëza të llojllojshme. Por, ai edhe më tepër hutohet dhe bie në panik, kur i duhet t'ia përgatis vetes ushqimin. Gjithashtu edhe gratë gabojnë shumë, kur e përjashtojnë bashkëshortin prej kuzhinës, duke e nënçmuar si dhe duke marrë në tallje gatishmërinë e tij, për t'i ndihmuar dhe njëherazi për t'u plotësuar në mënyrë komplementare. Kuptohet se në jetën e përbashkët martesore, nuk ndahen rolet dhe ngarkesat në mënyrë të barabartë, edhe pse janë të barabartë edhe luga dhe pitja, por mjerisht dinë të jenë edhe ngarkesë.

3) Civilizimi i sotëm

Gjatë historisë moderne, autoriteti i Kishës u zëvendësua nga ai i shtetit, ai i shtetit nga autoriteti i ndërgjegjes dhe, në kohën tonë, ky i fundit është zëvendësuar nga autoriteti anonim i censit të përbashkët dhe të opinionit publik si instrumente të konformizmit. Duke u çliruar nga format e vjetra të hapura të autoritetit, nuk menduam se ramë pre e një lloji të ri autoritetit. U bënë automatë që jetojnë në iluzionin e të qenurit individë të pavarur. Ky iluzion e ndihmon individin për të qëndruar i pavetëdijshëm për pasigurinë e vet, por kjo është tërë ndihma që mund t'i jepte një iluzioni të tillë (...) Jeton në një botë me të cilën nuk është më në marrëdhënie autentike, ku të gjithë dhe të gjitha tashmë janë të instrumentalizuar, ku është bërë një pjesë e makinës, që vetë duart e tij e kanë ndërtuar.

Po ashtu civilizimi i sotëm është i drejtuar kah specializimi i llojllojshëm. Por për botën e sotme është një tundim i madh: "specializimet e specializuara", pothuajse nuk ka ndonjë sferë të jetës që nuk e ka përfshirë ky sindromë i specializimit. Po ashtu ky sindromë shprehet edhe në jetën e përbashkët martesore. Zakonisht individ i frustruar thirret në profesionin e vet të specializuar, se gjoja qenka "dikush" dhe ashtu ia imponon palës tjetër jo vetëm mendimin, por edhe arsyen e manipulimit. Në rastet e shumta thirrja në autoritetin është "irracional". Personi i tillë e harron, se me këtë qëndrim dhe arsyetim e shpreh varfërinë e brendshme. Sidoqoftë fusha e specializimit dhe profesioni i individit, duhet të jetë në shërbimin e përbashkët, duke kontribuar dhe plotësuar rrugën e përbashkët në jetën e martesës, po ashtu i ndihmon edhe në plotësinë e jetës psiko-shpirtërore.

Kusht kryesor është për ata të cilët dëshirojnë të jetojnë në bashkësinë e martesës për t'u shkundur

nga kompleksi i superioritetit, si njëres ashtu edhe tjetres palë. Parimisht duhet ta përqafojnë idenë e shëndoshtë: gjithherë i gatshëm për t'u mësuar dhe për t'u begatuar prej palës tjetër. Kushti i dytë është që me këmbëngulje të përjashtohen prej gjirit martesor: talljet dhe nënçmimet njëres apo tjetres palë. Të gjitha pa aftësitë të rikthehen në aftësi si dhe jeta si e tillë le të jetë mësuese. Sepse dashuria martesore nuk përfundon vetëm me kurorë kishtarë në bankat e kishës, por ajo duhet dita-ditës të hulumtohet, të fisnikërohet, të begatohet, bile gjatë tërë jetës deri në vdekje.

Si kusht i tretë duhet po ashtu të shkarkohemi nga paragjykimet e mjedisit. Individit si i tillë, pse plotësohet si dhe harmonizohet me partnerin martesor, ai nuk do të jetë i varur prej tjetrit, por edhe më tepër do të pasurohet, do të begatohet, bile edhe më tepër fiton jo vetëm në lirinë e jetës por edhe fisnikërimin personalitetit. Edhe pse na duket si paradoks ky pohim, por në realitet të dy palët do të jenë edhe më të lirë dhe më të fisnikëruar, duke kontribuar për një botë më të mirë dhe më njerëzore!

4) Shkundja nga paragjykimet

Ne duhet t'i kemi gjykimet tona edhe ato sa më të qarta dhe reale, ndërsa paragjykimet janë jo reale dhe vdekjeprurëse jo vetëm për bashkësinë njerëzore por edhe për çiftin martesor. Për ta arritur një qëllim të tillë kërkohet shkundja e paragjyimeve. Kuptohet një nga detyrat kryesore është që çiftin martesor të shkundet nga paragjykimet si dhe thashethemet e mjedisit. Të fejuarit si dhe të dashëruarit duhet të aftësohen për ta pranuar njëri-tjetrin, ashtu siç janë në realitet, me gjitha tiparet pozitive dhe ato negative. Në mënyrë pozitive dhe konstruktive i pranojmë dallimet e tjetrit, duke u begatuar edhe më tepër si në dallimet pozitive po ashtu edhe atyre negative, të fundit mundohen së bashku çifti për t'i fisnikëruar. Për këtë qëllim është e domosdoshme shkundja prej paragjyimeve të rrethit shoqëror. Posaçërisht janë të theksuar në hapësirën shqiptare paragjykimet e gjinive (mashkull - femër ose djalë - vajzë) dhe prej kah rrjedhin edhe diskriminimet gjinore. Në vend t'i pranojmë dallimet gjinore, të cilat na plotësojnë, na zbusin si na fisnikërojmë, nganjëherë bëhen shkasi i urrejtjes dhe përbuzjes, duke nënçmuar tjetrin vetëm për vete se është i kësaj gjinie.

Ndoshta më shumë vlen kjo vërejtje për meshkujt të cilët janë të rritur në këtë frymë diskriminuese, se për femra. Sepse meshkujt që nga

fëmijëria e hershme prindërit si dhe mjedisi i ngarkojnë me paragjykimet e tilla, se veten e pranojnë si më të vlefshëm dhe superior, ndërsa vajzat binden se janë më të pavlershme, inferiore. Si njëra ashtu edhe tjetra palë duhet të shkunden nga kjo mendësi, djemtë nga superioriteti ndërsa vajzat nga inferioriteti i paragjykimeve. Përndryshe u këshillohet si mashkullit ashtu edhe femrës, me paragjykimet e tilla mos të hyjnë në bashkësinë e përbashkët në martesë. Sepse, si herët ose vonë do t'u hakmerret dhe do të bien fli një dashurie e cila nuk është dashuri por çoroditja e saj!

Si kusht i dytë kërkohet prej çiftit martesor, që të janë të aftë për ta pranuar edhe llojshmërinë dalluese njërës dhe tjetrës palë, që në vetvete është diçka krejtësisht e natyrshme. Ata duhet të mësohen ta pranojnë shoqi-shoqin ashtu siç janë në realitet pa ndonjë zbulurim apo hyjnizim, gjithashtu pa ndonjë lloj nënçmimi apo përbuzje ose satanizimin e palës tjetër. Pakusht pranohen të gjitha vetitë e individit ashtu siç janë, por me individin duhet të pranohen edhe aftësitë e tija, të cilat askurrë nuk janë të njëjta. Të jemi të kënaqur dhe të lumtur me ato begati dhe aftësi që i ka shoku martesor dhe t'ia

pranojmë siç pranohen edhe aftësitë dhe begatitë tona. Diskualifikimet dhe nënçmimet si dhe përbuzjet duhet të hidhen jashtë oborrit martesor.

Si të harmonizohen pikëpamjet (botëkuptimet) e ndryshme në jetën martesore? Për shembull femra më tepër kujdeset dhe i intereson familja, ndërsa meshkujt më tepër kujdesohen dhe u intereson politika, si fjala vjen, kjo do të ndodh kur lexohet gazeta, vetvetiu kuptohet se nuk mund njëherazi ta lexojnë gazetën burri dhe gruaja, por duhet të gjendet kompromisi, që nuk lëndon barazinë. Në këtë rast kompromisi do të ishte sipas interesit, ashtu burri do të lexojë ato faqe të politikës dhe të sportit, ndërsa gruaja do të lexojnë ato faqet që i interesojnë asaj, dhe kështu do të humbet shkaku i grindjes si dhe evidentohet konfrontimit që përfundon zakonisht në konfliktet e rënda. Këmbimi i interesave mund t'i afrojë njërin dhe tjetrin: burri me ndjeshmëri pedante i përshtatet rrethit, ashtu ka mundësi ta kuptojë bashkëshorten dhe botëkuptimin e saj të interesit, ndërsa gruaja gjithashtu do t'i afrohet burrit me delikates dhe do t'i shprehin interes edhe për lëmit e sferës, që i takojnë burri të saj, siç është politika, ekonomia, sporti etj.



Dom Lush GJERGJI
Prishtinë

SHËN NËNË TEREZA (GONXHE BOJAXHIU):
“FJALIMI NË CEREMONINË E DORËZIMIT TË ÇMITIT NOBEL PËR PAQE

Fjalimi i Shën Nënë Terezës mbajtur në ceremoninë e dorëzimit të Çmimit Nobel për Paqe në Oslo më 10 dhjetor 1979.

“Me që jemi mbledhur të gjithë bashkë, mendoj se, për të falënderuar Zotin e Çmimin Nobel për Paqen, do të ishte vërtet e bukur të luteshim me lutjen e Shën Françeskut të Asizit, që më mahnit gjithnjë shumë – ne e themi këtë lutje çdo ditë pas Kungimit, sepse tepër e përshtatshme për secilën nga ne. Më bën të mendoj se katër-pesëqind vjet më parë, kur Shën Françesku e krijoi këtë lutje, njerëzit duhet të kalonin po ato vështirësi, që kemi sot, me që na përshtatet kaq shumë.

Mendoj se disa nga ju e kanë me vete, prandaj, të lutemi së bashku. Ta falënderojmë Zotin për mundësinë që kemi, gjithë së bashku, sot, për këtë dhuratë të paqes, që na kujton se jemi krijuar për ta jetuar këtë paqe, se Jezusi u bë njeri, për t'ia sjellë pikërisht këtë lajm të mirë të varfërve. Ai, edhe pse Zot, u bë njeri në gjithçka, veç mëkatit, dhe e shpalli botërisht se kishte ardhur për ta sjellë këtë lajm të mirë. Lajmi ishte paqja për të mbarë njerëzit vullnetmirë, ishte paqja e zemrës, që e dëshirojmë të gjithë. Zoti e deshi botën aq, sa të jepte Birin e vetëm për t'ua bërë njerëzve këtë dhuratë. E si mund të themi se bëri keq, pse e deshi botën aq, sa të jepte Birin e vet? E ia dha Virgjërës Mari. E ajo, ç'bëri pastaj? Sapo e ndjeu gjallë, shpejtoi ta jepte lajmin e, si hyri në shtëpinë e së kushërirës, foshnja - ende e palindur, në krahatorin e Elizabetës, u drodh nga gëzimi. Ferishtja e palindur qe lajmëtari i parë i paqes!

Njohu Princin e Paqes, njohu Krishtin, ardhur për të sjellë lajmin e mirë, për mua, për ty. E sikur të mos i mjaftonte që u bë njeri, deshi edhe të vdiste mbi kryq, për të treguar sa e madhe ishte dashuria e Tij për njeriun, për mua, për ty, për të gërbulurin e për të uriturin, që sillet lakuriq rrugëve jo vetëm të Kalkutës, por edhe të Afrikës, të Nju Jorkut, të Londrës, të Oslos, e nguli këmbë ta donim njëri-tjetrin, ashtu si na kishte dashur Ai vetë. Lexohet qartë në Ungjill: “Duajeni njëri-tjetrin, ashtu si ju desha unë, si ju dua. Ju dua, si më deshi Ati”. E Ati e deshi aq fort, sa ta dhuronte dhe më fort. E edhe ne duhet ta duam njëri-tjetrin, deri në dhembje. Nuk mjafton të themi: “Zotin e dua, por jo të afërmin!”. Shën Gjoni të kujton se gënjën kur

thua: “Zotin e dua, por jo të afërmin”. E si mund ta dashke Zotin, që nuk e sheh, kur nuk e do të afërmin, që e sheh, e prek, që jeton me të e pranë tij? Kështu ka shumë rëndësi të kuptojmë se dashuria, për të qenë e vërtetë, duhet të jetë e tillë deri në dhembje!

I dhembti Jezusit, kur na deshi. I dhembti fort. E për të qenë i sigurt se do ta kujtonim dashurinë e tij të madhe, u bë Buka e jetës, që të shuante urinë tonë për dashuri. Urinë tonë për Zotin, sepse u krijuam për këtë dashuri. U krijuam sipas shëmbëlltyrës së tij. U krijuam për të dashur e për t'u dashur, e Ai u bë njeri, që ne të mund të donim, siç na deshi Ai vetë. Është Ai i urituri, i zhveshuri, i pastrehu, i sëmuri, i burgosuri, i vetmuari, i padashuri, e vijon të na kujtojë: “Ma keni bërë mua!”. Ka uri për dashurinë tonë, e kjo është uri për të varfrit tanë. Është ajo uri, që ju e unë duhet ta gjejmë, sepse mund ta kemi edhe në strehën tonë! Nuk e harroj kurrë mundësinë që pata për të vizituar një shtëpi, ku strehoheshin një mori pleqsh, të gjithë prindër me bij e me bija, të gjithë të flakur në atë institut dhe... të harruar!

Shkova atje e pashë se kishin gjithçka, gjëra të bukura, por të gjithë i kishin sytë të mbërthyer tek porta. E nuk pashë asnjë fytyrë të qeshur. Iu drejtova një motre e i thashë: - Si kështu? Si është e mundur që njerëz, të cilët i kanë gjitha të mirat, s'bëjnë tjetër, veçse shikojnë portën? E nuk shoh asnjë fytyrë të qeshur! Jam mësuar t'i shikoj njerëzit tanë të qeshur; madje edhe ata që janë duke dhënë shpirt, buzëqeshin lehtas. Vdesin me buzë në gaz. E ajo ma ktheu: - Kështu i ke ditë për ditë, presin e shpresojnë se do të vijë për t'i parë ndonjë prej bijve a bijave. E ndjejnë veten të plagosur, sepse të harruar, e, shikoni, pikërisht këtu duhet të trokasë dashuria. Ashtu si troket në shtëpitë tona varfëria, kur harrojmë të duhem. Ndoshta në familjen tonë kemi ndokënd që ndjehet i vetmuar, i sëmuri, i shqetësuar, e këto janë ditë të vështira për të gjithë. A jemi aty? A jemi për t'i ndihmuar? A është aty nëna, për të dëgjuar fjalën e pathënë të të birit? Çuditë kur shoh, në perëndim, shumë djem e vajza të drogjuara dhe e vras mendjen për të gjetur

psenë, pse ndodh kjo? E përgjigjja është: sepse nuk kanë asnjëri në familje që t'i dëgjojë. Babai e nëna janë gjithnjë të zënë, aq sa të mos kenë kohë deri për fëmijët e vet. Prindërit e rinj janë në ndonjë zyrë, kur fëmija u bledh rrugëve, gati për të rënë në ndonjë grackë. E ne jemi duke folur për paqen! Pikërisht këto janë gjërat, që e rrënojnë paqen, por unë nuk heq dorë nga mendimi se sot për sot armiku më i rrezikshëm i paqes është aborti, sepse luftë e drejtpërdrejtë, vrasje e drejtpërdrejtë, mbyetje e fëmijës me dorën e vetë s'ëmës.

E lexojmë në Shkrimin Shenjt. Zoti e thotë tepër qartë: “Edhe sikur nëna ta harronte foshnjën, unë nuk do të të harroj! Të kam skalitur në pëllëmbë të dorës!”. Jemi të skalitur në pëllëmbën e dorës së Tij, jemi pranë Tij! E edhe foshnja e palindur është e skalitur në pëllëmbën e dorës së Zotit. E ajo që më trondit më shumë, është fillimi i kësaj fraze, janë fjalët: “Edhe sikur nëna të harronte...”. Më duket gjë e pamundur, por megjithatë, edhe nëna mund të harrojë, na kujton Zoti, në sa unë nuk do të harroj kurrë. Sot për sot, arma më e rrezikshme kundër paqes, është aborti. Nëse ne jemi këtu, jemi sepse prindërit tanë na deshën. Nuk do të ishim, nëse nuk do të na kishin dashur. Shumëkush interesohet për fëmijët e Indisë e të Afrikës, ku vdesin me mijëra nga mungesa e ushqimit. Por në vende të tjera miliona fëmijë mbyten nga vetë prindërit e tyre. E nëse një nënë mbyt fëmijën e vet, pse u dashka të çuditemi, kur njerëzit ia marrin shpirtin njëritjetrit?!

Prandaj bëj thirrje, në Indi e kudo: “Na i jepni ne fëmijët, nëse nuk i doni, në këtë vit, që u është kushtuar. Çfarë kemi bërë për fëmijët? Në fillim të vitit kam thënë, kudo që kam folur: të punojmë këtë vit, që çdo fëmijë, i lindur e i palindur, të duhet. E sot, që përfundon viti, pyes: “A e kemi dashur çdo fëmijë të lindur a të palindur?”. Do t'ju kujtoj diçka prekëse. Po luftojmë kundër abortit përmes bijësimeve, duke shpëtuar kështu mijëra jetë. U kemi bërë thirrje të gjitha klinikave, spitaleve, stacioneve të policisë: ju lutemi, mos i mbysnit fëmijët, i marrim ne. Në çdo orë të ditës e të



natës, është dikush, që ka nevojë për ndihmë. Kemi shumë vajza-nëna: thojuni të vijnë tek ne, ne do të kujdesemi për fëmijën e tyre, do t'i gjejmë strehë. Kemi kërkesa të panumërta nga ana e familjeve pa fëmijë, e për ne ky është hir i Zotit. Po bëjmë edhe një gjë tjetër, shumë të bukur, po u mësojmë lypësve tanë, të gërbulurve tanë, banorëve të barakave, njerëzve tanë të sokaqeve, metodat e planifikimit familjar.

E vetëm në Kalkutë, në gjashtë vjet, e theksoj, vetëm në Kalkutë, kemi pasur 61273 fëmijë më pak nga familjet, që do t'i kishin nxjerrë në dritë, sepse u mësuan të praktikojnë këtë metodë natyrore të përkorjes, të vetëkontrollit, me dashuri reciproke. U mësojmë atyre metodën e temperaturës, që është shumë e bukur, krejt e thjeshtë, e njerëzit tanë të varfër e kuptojnë fare mirë. A e di ç'më kanë thënë? Familja jonë është e shëndoshë, e bashkuar e mund të kemi fëmijë sa herë të duam! E qartë, pra, këta njerëz rrugësh, këta lypës, bëjnë shumë më tepër se mund të bëni ju e gjithë të tjerët, që mund t'i njohin metodat e mjetet, pa e shkatërruar jetën, të cilën Zoti e krijoi në ne. Të varfrit janë njerëz të mëdhenj. Mund të na japin shumë mësim të bukura. Një ditë një prej tyre erdhi të më falënderojë e më tha: “Ju që keni bërë kushtin e pastrisë, jeni njerëzit më të aftë për të na mësuar planifikimin familjar”. Sepse nuk është tjetër, veçse vetëkontroll për dashuri reciproke. E mendoj se kemi thënë një frazë shumë të bukur. E këta janë njerëz, që ndoshta nuk kanë asgjë për të ngrënë, ndoshta-ndoshta nuk kanë as strehë, ku të struken. Gjithsesi, janë njerëz vërtet të mëdhenj! Një mbrëmje dolëm e mblodhëm katër vetë, të flakur në rrugë të madhe. Ndërmjet tyre, një grua në kushte të tmerrshme. U thashë motrave: “Kujdesuni ju për tre të parët, për këtë, që duket më keq, po kujdesem vetë. U kujdesa me gjithë dashurinë, që kisha në shpirt. E shtriva butë në krevat e i pashë në fytyrë një buzëqeshje të mrekullueshme. Ma mori dorën në dorën e saj, që akullohej, e më tha një fjalë të vetme: Faleminderit! E vdiq! Nuk mund të mos zbrisja në fundin e ndërgjegjes sime atë ças, përball së vdekurës, e të mos e pyesja veten: “Ç'do të kisha bërë, po të isha në vend të saj?”. Përgjigjja ishte e thjeshtë. Do të isha munduar të tërheq vëmendjen, do të kisha thënë se kam uri, kam ftohtë, dhimbje, se po vdes, a ku ta di unë ç'fjalë të tjera. Ndërsa ajo më dha shumë më tepër, sesa i dhashë: më dha të fundmen dashuri. E vdiq me buzë në gaz.

Ashtu si burri, që e gjetëm në kanal, gjysmë të brerë nga krimbat e e sollëm në shtëpi. Ai e mbylli jetën me fjalët: “Jetova në rrugë të madhe, si

kafshë, por po vdes si engjëll, në krahët e dashurisë e të kujdesit”. Ishte mahnitëse të shikoje madhështinë e këtij njeriu, që mund të fliste kështu, mund të vdiste kështu, pa akuzuar kënd, pa mallkuar, pa bërë krahassime. Si engjëll! E kjo është madhështia e njerëzve tanë. E për këtë ne besojmë se Jezusi ka thënë: “Isha i uritur, isha lakuriq, isha pa strehë, isha i braktisur, i pa dashur, i pa kujdesur, e ju bëtë gjithçka mund të bënit për mua!”. Besoj se ne nuk jemi veprimtarë të vërtetë shoqëror. Ndoshta, për sytë e botës, puna jonë mund të duket si shoqërore, po në të vërtetë ne jemi kundruese, në zemër të botës. Sepse prekim Korpin e Krishtit njëzet e katër orë në ditë. E kemi njëzet e katër orë këtë prani, e kështu edhe ju e unë. Edhe ju mund të bëni provë e ta çoni Zotin në familjet tuaja, sepse familja, që lutet së bashku, është e bashkuar. E besoj se në familje ne nuk kemi nevojë për bomba e armë atomike, që shkatërrojnë. Për të sjellë paqen, mjafton të jemi bashkë, të duhemi. Ta çojmë, pra, këtë paqe, këtë gëzim, këtë forcë të pranisë së Zotit në shtëpitë tona. E kështu do të mund të fitojmë mbi çdo të keqe, në një botë ku ka shumë vuajtje, shumë urrejtje, shumë mjerim. Prandaj ne, me lutjen tonë, me flijimin tonë, ta nisim betejën e dashurisë pikërisht nga shtëpia! Dashuria nis në shtëpi, e nuk ka rëndësi ajo që bëjmë. Rëndësi ka dashuria, në çdo gjë që bëjmë. I përket Zotit, që është i gjithëpushtetshëm, ta gjykojë dashurinë me të cilën shërbejmë. Me të cilën i shërbejmë Atij vetë, në njeriun që vuan. Jo shumë kohë më parë, në Kalkutë, na mungoi sheqeri e nuk e di sesi, po fëmijët e morën vesh. E një fëmijë nja katër vjeç, fëmijë induistësh, duke shkuar në shtëpi, u tha prindërve: “Nuk do të ha sheqer për tri ditë. Do t’ia jap sheqerin tim Nënë Terezës, për fëmijët e saj”. Pas tri ditësh nëna e babai i fëmijës e sollën sheqerin në shtëpinë tonë. Nuk i kisha takuar kurrë e fëmija e tyre mezi e shqiptonte emrin tim, por e dinte mirë ç’kish ardhur të bëjë. Kishte ardhur të dhurojë dashuri. Edhe ju po më dhuroni dashuri. Që kur erdha këtu, u rrethova nga dashuria, nga dashuria e madhe, që përpiqet të kuptojë gjithçka. E m’u duk se po i shikonit me vëmendje të veçantë të gjithë njerëzit e Indisë e të Afrikës. E m’u duk sikur isha në shtëpinë time. Plotësisht në shtëpinë time, këtu, mes jush!

Prandaj erdha t’ju flas. Dëshiroj ta shikoni të varfrin këtu, pikërisht në shtëpinë tuaj. E të filloni ta doni, pikërisht këtu. Të bëheni lajm i mirë për njerëzit tuaj. E t’i thoni fqinjët: “E dini kush jam?”. Kam jetuar një çast tejet të jashtëzakonshëm në një familje induiste me tetë fëmijë. Një zotëri erdhi në

shtëpinë tonë e tha: “Nënë Terezë, njoh një familje me tetë fëmijë, që nuk ka ç’të hajë prej ditësh. Bëj diçka për të!”. Pa e zgatur, mora ca oriz e u nisa. E i pashë fëmijët, e pashë në sytë e tyre ethet e urisë. Nuk e di nëse keni parë ndonjëherë sy të tillë. Po unë i shikoj tepër shpesh. Pashë edhe të ëmën që e ndau orizin e doli. Kur u kthye, e pyeta: “Ku shkove?”. M’u përgjigj thjesht: edhe ata kanë uri. Po kush ishin ata? Mësova se e kishte fjalën për një familje myslimane. Me të e kishte ndarë kafshatën e gojës. Nuk i solla më oriz atë mbrëmje, për ta shijuar me fund gëzimin, që buronte nga ndarja e ushqimit me të tjerët. E lexova gëzimin në sytë e fëmijëve të kësaj nëne, që s’kishte as një dorë oriz, por kishte kaq shumë dashuri për të dhuruar. Kështu, pra, dashuria nis pikërisht në shtëpi. E dëshiroj që edhe ju të dhuroni dashuri, ashtu si po ma dhuroni mua, gjë për të cilën ju jam shumë mirënjohëse.

Ishte një përvojë e jashtëzakonshme, që do ta marr me vete në Indi, ku do të shkoj javën e ardhshme, me 15 besoj, duke mbartur me vete dashurinë tuaj. Me bindjen se nuk më dhuroat teprica, por dashurinë që dhemb. Prandaj falënderoj Zotin që na dha mundësinë të njihemi, të ndjehemi kaq afër. Kështu mund t’i ndihmojmë jo vetëm fëmijët indianë e afrikanë, por të gjithë fëmijët e botës. E me këtë çmim, që e mora si çmim të paqes, do të përpiqem të ndërtoj një shtëpi për ata që nuk kanë shtëpi. Sepse besoj që dashuria nis nga shtëpia e se, po të mund të ndërtojmë një shtëpi për të varfrit, prej saj do të rrezatojë kudo vetëm dashuri. E prej dashurisë, do të përhapet paqja, lajmi i mirë për të varfrit. Për të varfrit e familjes sonë, së pari, të vendit tonë, e edhe të mbarë botës. Por për ta bërë këtë, jetët tona duhet të enden me lutje!

E ndjej se mundimet e Krishtit rijetohen përsëri kudo, e ne i ndajmë me Të këto mundime, këtë dhembje. Në mbarë botën e jo vetëm në vendet e varfra. E kjo, nga që mendoj se është shumë më vështirë ta zhdukësh varfërinë e botës së pasur perëndimore, se atë të botës së varfër. Kur e marr një njeri nga rruga, të uritur për vdekje, i jap një pjatë oriz, një copë bukë, e kam kënaqur. Ia kam shuar urinë, që e grin. Po njeriun, që është zhytur në heshtje, që ndjehet i padëshiruar, i pa dashur, i trembur, i flakur nga radhët e shoqërisë - si mund ta kënaq? Më duket tepër e vështirë. Motrat tona po punojnë për këtë tip njeriu, që mund ta quajmë i varfëri i perëndimit. Njeri, që ka etje e uri për pakëz dashuri! Atëherë ju ftoj të luteni për ne, që të jemi të afta për t’u bërë ne vetë lajmi i mirë, me bindjen se

nuk mund të realizojmë asgjë pa ju, sepse pikërisht ju duhet t'ju kemi përkrah në vendin tuaj. Duhet t'i njihni të varfrit. Vërtet këtu njerëzia ka të mira materiale, ka gjithçka, por mendoj se po të kërkojë nëpër shtëpi, vështirë se do të gjejë një buzëqeshje të dalë nga zemra. E duhet ta kemi mirë parasysh se buzëqeshja është fillesa e dashurisë. Të takohemi gjithnjë, prandaj, me buzë në gaz, sepse kur takohemi kështu, nuk është e mundur të mos bëjmë diçka të mirë. Lutuni, pra, për motrat tona, për vëllezërit tanë, për bashkëpunëtorët e përhapur në mbarë botën: “Lutuni t'i qëndrojnë përherë besnikë dhuratës së Zotit, ta duan e t'i shërbejnë në të varfrit, së bashku me ju. Atë që kemi bërë, nuk do të mund ta bënim, nëse ju nuk do të na kishit ndihmuar me lutjet tuaja, me dhuratat tuaja, duke dhënë vazhdimisht. Veç nuk dua të më jepni atë që ju tepron. Nuk dua teprica. Dua dashuri, deri në dhembje. Një ditë më parë mora 15 dollarë nga një burrë, që nuk lëviz fare nga krevati prej njëzet vjetësh. E vetmja pjesë e trupit, që mund ta lëvizë, është dora e djathtë. Dhe e vetmja gjë, që e kënaq, është duhani. E pra shi ky burrë më tha: nuk kam tymitur prej një jave, për t'i kursyer këto para, që po t'i dërgoj.

Duhet të ketë qenë një flijim i tmerrshëm për të, por edhe tepër i bukur. Me paratë e tymit të tij të pashijuar, bleva bukë për të uriturit, për gëzimin e të dyja palëve: ai dha, të varfrit morën. E kjo është dhuratë e Zotit për mua e për ju, ta ndajmë dashurinë me të tjerët. E ta bëjmë, si t'ia kishim bërë Jezusit. Ta duam njëri-tjetrin, si na deshi Ai. Ta duam Atë vetë me dashuri të pandarë. Ta duam njëherësh Atë e njëri-tjetrin, sidomos tani, që Krishtlindja është kaq afër. Ta ruajmë gëzimin, që buron nga dashuria e Krishtit në zemrat tona. E ta ndajmë këtë gëzim me të gjithë ata që takojmë. E ky gëzim vezullues është i vërteti. Nuk kemi arsye të mos jemi të lumtur, sepse Krishti është me ne. Është në zemrat tona. Krishti është në të varfrin, që takojmë; në buzëqeshjen që dhurojmë e që na dhurohet. Të zotohemi, prandaj që asnjë fëmijë të mos jetë i padëshiruar, e që do ta pranojmë me buzë në gaz, posaçërisht atëherë kur është tepër vështirë të buzëqeshësh.

Pak kohë më parë jetova një ngjarje, që nuk do ta harroj kurrë. Na erdhën për vizitë rreth 40 profesorë, nga

universitete të ndryshme të SHBA-ve. Erdhën në Kalkutë në shtëpinë tonë. Po flisnin njëri me tjetrin e po thoshin se kishin qenë në shtëpinë tonë ku strehojmë njerëzit në prag të vdekjes. E kemi një shtëpi të tillë në Kalkutë, ku kemi mbledhur më se 360.000 njerëz vetëm nga rrugët e qytetit e, nga ky numër i madh, më se 18.000 vdiqën në paqe me njeriun e me Perëndinë. U nisën për në shtëpinë e Zotit, pasi erdhën në shtëpinë tonë, ku u folëm për dashurinë, për mëshirën.

Si u fola për këtë shtëpi e për këta njerëz, njëri prej profesorëve m'u lut: - Nënë, ju lutem, na thoni diçka, që të mund ta kujtojmë. E u thashë atyre: - Buzëqeshini njëri-tjetrit, kushtojini ca kohë familjeve. Buzëqeshni! E njëri prej tyre, çuditërisht, më pyeti: “Jeni e martuar?”. Po, ia drodha, dhe shpesh e kam të vështirë t'i buzëqesh Jezusit, sepse nganjëherë kërkon edhe tepër nga unë. Kjo është e vërtetë e prej këndeje vjen dashuria, kur Krishti është kërkuar, e ne, megjithatë, mund t'i japim Atij me gëzim. Po e them këtu se, po s' shkoja në qiell për ndonjë meritë tjetër, sigurisht që do të shkoj për shkak të publicitetit, sepse më pastroi, më sakrifikoi e më bëri vërtet të gatshme për të shkuar në Qiell. Mendoj se duhet ta jetojmë bukur jetën tonë, sepse Jezusi është me ne, Krishti na do. Nëse do të mendonim vetëm se Jezusi na do e se kemi mundësi t'i duam edhe të tjerët, si na do Ai, jo në gjërat e mëdha, por në të voglat, të bëra me shumë dashuri, atëherë Norvegjia do të bëhej fole dashurie. E sa gjë e bukur do të ishte, që pikërisht këtu të na dhurohej një qendër për paqen! Që prej këtu të delte gëzimi për jetën e fëmijëve të palindur. Nëse ju bëheni dritë, që digjet në botë për paqen, atëherë vërtet Nobeli për Paqen është dhuratë për popullin norvegjez. Zoti ju bekoftë!”.



Don GJOVANI KOKONA
Kanada

ETAPA POST-MARTIRE

Data 5 nëntori i vitit 2016 shënoi një kremtim që ishte në të njëjtën kohë një mbyllje dhe një hapje e re e ngjarjes.

Mbyllës për arsye të kulmimit të një procesi që kishte komplikimet e veta. Një proces i ndërlikuar edhe për gamën e gjerë, sepse gjatë procesit u punua jo vetëm për mbledhjen e informatave për 38 të Lumët e kohës së komunizmit, por edhe për dy periudha të tjera: atë të ndërhyrjeve malazeze (procesi për At Luigj Paliq o.f.m.) dhe të regjimit të Zogut (procesi për Don Gjon Gazullin).

Një proces jo i lehtë për shkak se shpesh pengesat vinin nga vetë aktori i procesit, pa lënë mënjane këtu kushtet e vështira materiale e financiare në të cilën punohej.

Hapës për arsyen e thjeshtë se Lumnimi shënon një moment të rëndësishëm por jo përfundimtar në ecurinë e shpalljes së një shenjtë, atë përmbyllës e shënon kanonizimi. Në këtë fazë postulatora (nëpërmjet personit të zëvendës postulatorit në bashkëpunim me postulatorin në Romë) ka rol kryesor në përhapjen e devocionit nëpërmjet konferencave (shumë njerëz në Shqipëri, përfshirë edhe ipeshkvinj, meshtarë, rregulltarë/e nuk kanë njohuri për këta martirë), organizimit të momenteve të lutjes etj.

Për tu theksuar është fakti që kjo fazë e kanonizimit kërkon edhe vërtetimin e një mrekullie.

Në të njëjtën kohë kjo fazë drejt kanonizimit sjell në vetvete edhe domosdoshmërinë e një reflektimi për fazën historikë të sapokaluar, atë të komunizmit. Shumë të rinjve e të rejave edhe nga rregulltarë/e që udhëheqin shkolla katolike me të drejtë u flitet për krimet e nazizmit në Auschwitz (1940-1945, rreth 5 vite) por jo me të drejtë u flitet pak ose aspak për krimet komuniste në burgun e Shqipërisë (1944-1991, rreth 47 vite).

Akoma Kisha në Shqipëri nuk është bërë pjesë e debatit për dërgimin përpara drejtësisë të autorëve të krimeve, a thua se Kisha nuk ka të bëjë me këtë pjesë. Akoma sot sigurimi i Shtetit nuk tregon ku i kanë eliminuar apo varrosur një

pjesë të të pushkatuarve apo të atyre që vdiqën në burgje. Akoma sot shteti shqiptar më lehtë kompenson disa privatë për marrjen e pronave që iu është bërë në komunizëm, sesa kompenson Kishën Katolikë. Harrojmë që e drejta e pronës dhe vendosja e drejtësisë janë baza të një shteti demokrat.

Pse duhet të kemi frikë të kërkojmë të drejtën e mohuar? Martirët na tregojnë se duke pasur konceptin Kishë nuk hezituan të flijohen që kësaj Kise të mos i mohoheshin të drejtat.

Nga një analizë e martirëve duhet të lindë edhe reflektimi mbi ungjillëzimin. Ungjillëzimi lind nga Ungjilli, pra nuk është përhapja e një ideje personale. Kisha e kryen një gjë të tillë nëpërmjet anëtarëve të saj. Martirët na dëshmojnë fjalën, premtimin e Krishtit që Shpirti do të japë forcën në momentin e duhur për të dëshmuar. Prandaj edhe sot, si individë si Kishë, duhet të jemi hapur ndaj Shpirtit. Nën frymëzimin dhe udhëheqjen e Shpirtit mund të tejkalohet mendësia e gabuar, që, me vetëdije apo pa vetëdije, na shtyn të veprojmë me parimin se një shprehi e jetës kishtarë “lind dhe mbaron me mua”.

Në këtë drejtim duhet të dimë të përballemi me sfidat e pashmangshme. Përgatitja dhe angazhimi i një laikati të shëndoshë, rritja e nivelit të formimit në Seminar, formimi shpirtëror dhe intelektual i rregulltareve, kujdesi, koordinimi dhe shoqërimi i emigracionit janë pa dyshim sfida të ditëve të sotme. Në këtë kornizë hyn edhe forcimi i strukturës kishtarë, që të jetë sa më pak me natyrë personale. Nevojitet krijimi i një mendësie në nivelin e dioqezës dhe të famullive, që të ketë si synim përfshirjen reale të besimtarëve në përmasat e ndryshme të jetës kishtarë. Një formë konkrete e kësaj përfshirjeje mund të jetë themelimi i këshillave për çështjet baritore dhe për çështjet ekonomike, ku anëtarëve laikë duhet t'u jepet pesha që u takon. Nuk duhet të mungojë as kujdesi për të eliminuar nga strukturat aktuale

elementin komunist, akoma i pranishëm në forma të ndryshme. Jo rrallë ngrehina kishtarë vepron si në një tranzicion, në të cilin çdokush kërkon të mbijetojë, e ndonjë herë edhe në dëm të të tjerëve.

Në ungjillëzim duhet të nxjerrim nga pluhuri edhe traditën kishtarë shqiptare, e cila mund të pasurohet nga traditat e kishave të tjera, por jo të zëvendësohet nga këto, duke i kopjuar këto të fundit pa ia përshtatur kontekstit vendas. Duhet marrë elementët pozitivë të traditës e të pasurohen më tej, por jo të shpërfillët tradita.

Papa Françesku, nëpërmjet krijimit të kardinalit Troshani, edhe një herë na thotë se duhet ti hapim sytë e mendjes e të zemrës. Kjo Kishë nuk po fillon me ne, por ne po korrim frytet e asaj Kise që i qëndroi stuhisë, për të dëshmuar të Vërtetën, për të dëshmuar Fjalën. Prandaj nëse deri më tani nuk e kemi parë këtë Kishë, le të na nxisin gjestet e Papës për tu ndalur e për të parë nga ku jemi nisur. Duke pasur të qartë pikënisjen atëherë mund të shtrojmë përpara edhe rrugën ku duhet të ecim. Shqipëria në disa aspekte ka ndryshuar, por në disa aspekte të tjera ka mbetur e ngrirë. Për shembull sot nuk mund të vazhdojmë të konsiderojmë të tillë një famulli të cilës i kanë mbetur ndoshta 30 familje, për arsye se dikur kishte ndoshta 200 apo më tepër. As nuk mund të

konsiderojmë katolike zona ku 80 për qind e popullsisë nuk vjen në Kishë “sepse janë katolikë”. Ndërsa aty ku gjallëria e famullisë është e dukshme lind natyrshëm pyetja së çfarë mund të bëjmë më shumë apo çfarë duhet të përmirësojmë. Këto dhe fakte të tjera duhet të na bëjnë të hapim sytë e të konsiderojmë tipologjinë e ungjillëzimit, çfarë është e nevojshme sot.

Natyrisht është i nevojshëm edhe një organizim i mirë i forcave njerëzore, në mënyrë që të ketë një kujdes baritor jo vetëm për ata besimtarë që janë brenda por edhe për ata që janë jashtë Shqipërisë. Sa mirë kur u kërkohej ndihmë ekonomike për strukturat tona në vend besimtarëve që janë jashtë, por sa keq kur interesi baritor për ata shkon nga niveli i ulët deri në shpërfillje. E këtu harrojmë që shqiptarët vazhdojnë të largohen në forma nga më të ndryshmet nga Shqipëria edhe sot, dhe qendrat ekzistuese në ato vende ku ata janë shpërngulur bëhen si ai 'miku i mirë që të hap derën e nuk mbetesh jashtë'.

Duke iu rikthyer martirëve, urojmë e shpresojmë që të na pasurojnë e të marrim frymëzim për të dëshmuar Ungjillin, duke u shfaqur përpara kombit ashtu siç Kisha është: një e vetme me Krishtin dhe në Krishtin.



MËNJANOHET KUSH NUK SHËRBEN

Ligjërimi e mbajtur nga Papa Françeko në meshën eucaristike të çuar në oborrin e kishës së Shën Piut të Pietrelcinës në San Giovanni Rotondo.

Nga leximet biblike që dëgjuam do të donja të veçonja tri fjalë : lutje, vogjëli, urtësi.

Lutje. Ungjilli i sotëm na paraqet Jezusin që lutet. Nga zemra e tij dalin këto fjalë : “Të lëvdoj, o Atë, Zot i qiellit e i tokës...” (Mt 11,25). Jezusit lutja i dilte vetiu, por nuk ishte një *optional* : zakonisht tërhiqej në vende të shkreta për t'u lutur (Mc 1,35). Dhe dishepujt zbuluan kështu me natyrshmëri se sa e rëndësishme ishte lutja, deri sa një ditë i kërkuan : “O Zot na mëso të lutemi” (Lc 11,1). Nëse duam të shkërbejmë Jezusin, le të fillojmë edhe ne aty ku fillonte Ai, pra nga lutja.

Mund të pyesim veten ne të krishterët : a lutemi mjaftueshëm ? Shpesh, në çastin e lutjes, vijnë ndërmend gjithato shkaqe, gjithato gjëra të ngutëshme për t'u bërë..... Pastaj, herë herë, lihet mënjane lutja sepse rrëmbehemi nga një aktivizëm që bëhet i padobishëm kur harrohet “pjesa më e mirë” (Lc 10,42), kur harrohet se pa Të nuk mund të bëjmë asgjë (Gv 15,5), e kështu lemë lutjen. Shën Piu, në pesëdhjetëvjetorin e ngjitjes në qiell, na ndihmon, sepse si trashëgim na ka lënë lutjen. Porosiste : “Lutuni shumë, bijtë e mij, pa u lodhur kurrë” (Fjalë në Kuvendin e dytë ndërkombëtar të grupeve të lutjes, 5 maj 1966).

Jezusi në Ungjill na tregon edhe *se si* duhet m'u lutë. Para së gjithash thotë : “Të lëvdoj o Atë” ; nuk fillon duke thënë “kam nevojë për këtë e atë”, por duke thënë “të lëvdoj”. Nuk njihet ati pa i u hapur lëvdimit, pa i kushtuar kohën vetëm Atij, pa e

adhuruar. Sa e kemi harruar neve lutjen e adhurimit, lutjen e lëvdimit ! Duhet t'i rifillojmë. Secili mund të pyesi veten : si adhuroj un ? Kur e lëvdoj Zotin ? Është kontakti personal vetëm për vetëm, të qëndruarit në heshtje para Zotit, sekretit për të hyrë gjithënjë e më shumë në bashkësi me Të. Lutja mund të lindë edhe si kërkesë, edhe për një ndihmë të shpejtë, por piquet nëpërmjet lëvdimit e adhurimit. Lutje e pjekur. Atëherë bëhet vërtetë vetiake, si për Jezusin, që pastaj bisedon lirshëm me Atin : “Po o Atë, sepse kështu ke vendosur ti në mirësinë tënde (Mt 11, 26). E atëherë, në bisedën e lirë e të besueshme, lutja merr mbi vete gjithë jetën dhe e çon para Zotit.

Atëherë pyesim veten : lutjet tona i shëmbëllojnë asaj të Jezusit apo katandisen në thirrje të herëpashershme për ndihmë ? “Kam nevojë për këtë”, e atëherë shkoj shpejt të lutem. E kur nuk ke nevojë, çfarë bën ? Apo e kuptojmë si një qetësues për t'u pirë në doza të rregullta, për të lehtësuar stresin ? Jo, lutja është një shenjë dashurie, është të rrih me Zotin e t'i çosh Atij jetën e botës : është një vepër e domosdoshme përdëllimi shpirtëror. Nëse ne nuk do t'i besojmë vëllezërit, njerëzit Zotit, kush do t'a bëjë ? Kush do të bëhet fjalëmirë, kush do të shqetësohet për të trokitur në zemrën e Zotit për të hapur dyertë e mëshirës për njerëzimin në nevojë ? Për këtë Atë Piu na ka lënë grupet e lutjes. Atyre u tha : “Është lutja, ajo forcë e bashkuar e të gjithë shpirtërave të mirë, që lëviz botën, që ripërtërin ndërgjegjet, [...] që shëron të sëmurët, që shenjtëron punën, që ngre lart ndihmën shëndetësore, që jep forcën morale [...], që shtrin buzëqeshjen dhe bekimin e Zotit mbi çdo lloj ligështie e dobësie”. Le t'i ruajmë këto fjalë e të pyesim veten përsëri : a lutem un ? E kur lutem a dij të lëvdoj, të adhuroj, a dij të çoj jetën time e atë të gjithë njerëzve tek Zoti ?

Fjala e dytë : *vogjëli*. Në Ungjill Jezusi lëvdon Atin, sepse i ka zbuluar të fshehtat e Mbretërisë së tij të vegjëleve. Kush janë këta të vegjël që dijnë të mirëpresin të fshehtat e Zotit ? Të vegjlit janë ata që kanë nevojë për të mëdhenjtë, që nuk janë të



vetëmjaftueshëm, që nuk mendojnë se i mjaftojnë vetes. Të vegjël janë të gjithë ata që kanë zemrën e përvuajtur e të hapur, të varfër e në nevojë, që e ndjejnë nevojën për t'u lutur, për t'i besuar dikujt e për të qenë të shoqëruar. Zemra e këtyre të vegjëlve është si një antenë : rrok shenjën e Zotit, menjëherë, e kupton shpejt. Sepse Zoti kërkon takimet me të gjithë, por kush bëhet i madh krijon një shqetësim të pamasë, nuk arrin tek ai dëshira e Zotit : kur je i mbushur me vetevete, nuk ke vënd për Zotin. Prandaj Ai parapëlqen të vegjëlit, u zbulohet atyre dhe rruga për t'a takuar është të ulurit, të zvogëluarit së brendëshmi, të të quajturit nevojtarë. Misteri i Jezu Krishtit është mister i vogjëlisë : Ai është ulur, është asgjësuar. Misteri i Jezusit, ashtu siç e shohim në Ostien e çdo Meshe, është mister vogjëlie, dashurie të përvuajtur, e përceptohet vetëm duke u bërë të vegjël e duke shkuar me të vegjëlit.

Tani mund të pyesim veten : a dijmë t'a kërkojmë Zotin atje ku ndodhet ? Këtu është një faltore e veçantë, në të cilën Ai është i pranishëm, sepse aty gjenden shumë të vegjël të parapëlqyer prej Tij. Shën Piu e quajti “tempull të lutjes e të shkencës”, ku të gjithë janë të thirrur të jenë “rezerva dashurie” për të tjerët (*Fjala e mbajtur në përvjetorin e përrimit, 5 maj 1957*) : është *Shtëpia e Leçimit të Vuajtjeve*. Tek i sëmuri gjindet Jezusi dhe në kujdesin e dashur të atij që përkulet mbi plagët e të afërmit është rruga për të takuar Jezusin. Kush kujdeset për të vegjëlit qëndron në anën e Zotit dhe e mund kulturën e mënjanimet, që në të kundërt parapëlqen të fuqishmit dhe i quan të kotë të varfërit. Ai që parapëlqen të varfërit shpall një profeci të jetës kundër profetëve të vdekjes të çdo kohe, edhe të të sotmëve që mënjanojnë njerëzit, fëmijët, të moshuarit, sepse nuk shërbejnë më. Që fëmijë në shkollë na mësonin historinë e spartanëve. Më ka mbetur në mëndje ajo që na thonte mësuesja se kur lindte ndonjë fëmijë me të meta e çonin në një majë mali dhe e hidhnin poshtë, që të mos ishin këta vogëlushë. Ne fëmijët thonim: “Çfarë mizorie!”. Vëllezër e motra, ne bëjmë të njëjtën gjë, me më shumë ashpërsi, me më shumë shkencë. Ai që nuk shërben, ai që nuk prodhon përjashtohet. Kjo është kultura e përjashtimit, të vegjëlit nuk duhen sot. Prandaj edhe Jezusi është lënë mënjane.

Së fundi fjala e tretë. Në Leximin e parë Zoti thotë : “Të mos lavdërohet i dituri për dijen e tij, të

mos lavdërohet i fuqishmi për fuqinë e tij” (*Ger 9,22*). Dija e vërtetë nuk qëndron në të paturit e dhuntive të mëdha dhe forca e vërtetë nuk qëndron tek fuqia. Nuk është i ditur ai që tregohet i fuqishëm dhe nuk është i fortë ai që i përgjigjet së keqes me të keqe. E vetmja armë e urtë dhe e pathyeshme është mëshira e gjallëruar nga besimi, sepse ka fuqinë të çarmatosë forcat e së keqes. Shën Piu e ka luftuar të keqen gjatë gjithë jetës dhe ka luftuar urtësisht, si Zoti : me përvuejtësi, me bindje, me kryqin, duke ofruar dhimbjen për dashuri. E të gjithë kanë mbetur të mahnitur ; por të paktë janë ata që bëjnë të njëjtën gjë. Shumë janë ata që flasin mirë, por sa e imitojnë? Shumë janë të gatshëm për të vënë një “më pëlqen” në faqen e shenjtërve të mëdhenj, por cili bën si ata ? Sepse jeta e krishterë nuk është një “më pëlqen” apo një “jepem”. Jeta është erëkëndëshme kur falet si dhuratë ; bëhet pa shije kur mbahet për vete.

Në Leximin e parë Zoti shpjegon se ku duhet t'a marrim urtësinë e jetës : “Kush don të lavdërohet, le të lavdërohet [.....] se më njeh mua” (rr. 23). Të njohësh Atë, pra t'a takosh, si Zotin që shpëton e fal : kjo është rruga e urtësisë. Në Ungjillin Jezusi thekson : “Hajdeni tek un, ju të gjithë që jeni të lodhur e të shtypur (*Mt11, 28*).

Kush prej nesh mund të ndihet i përjashtuar nga ftesa ? Kush mund të thotë : “Nuk kam nevojë”? Shën Piu e ka falur jetën dhe vuajtjet e panumurta për të takuar vëllezërit me Perëndinë. Dhe mjeti vendimtar për t'a takuar është Rrëfimi, sakramenti i Ripajtimit. Aty fillon e rifillon një jetë e urtë, e dashur dhe e falur, aty fillon shërimi i zemrës. Atë Piu ka qënë një *apostull i rrëfyestores*. Edhe sot na fton aty ; e na thotë : “Ku shkon ? Tek Jezusi apo tek trishtimet e tua ? Ku kthehesh ? Tek ai që të shpëton apo në ligështimet e tua, në keqardhjet, në mëkatet e tua ? Hajde, hajde, Zoti të pret. Kurajë, nuk ka asnjë arsye kaq të rëndë që të të përjashtojë nga mëshira e tij”.

Grupet e lutjes, të sëmuret e *Shtëpisë së Leçimit*, rrëfyestorja ; tre shenja të dukëshme që na kujtojnë tre trashëgimi të vyera : lutja, vogjëlsia, urtësia. Të kërkojmë hirin që t'i kultivojmë çdo ditë.

Marrë nga “Avvenire”, 18 mars 2018
E përktheu: Eugjen Merlika

“MBI MBRETIN” NJË PASION NË GJUHËN E SARDENJËS

Retë, të shtyra nga era, përshkojnë shkëmbinjtë duke i ndarë si me thikë.

Në kolonën zanore dëgjohej zëri i një njeriu të moshuar, i cili reciton, me gjuhën e Sardenjës, disa vargje të shkurtra të profetit Isaia.

«Ai nuk kishte as pamje, as bukuri të kënaqshme. Nuk kishte asgjë. Dukej sikur ishte i dënuar nga Zoti. E kanë eliminuar nga bota për shkak të ligësisë së vetë njerëzimit. Si një gjykim fals. E kanë vrarë së bashku me njerëzit e këqij».

Në brendësinë e një grope shikohet fytyra e një fermeri të vjetër (Bruno Petretto), i cili interpreton rolin e Giuseppe d'Arimatea. Është ai që flet... Afër tij shfaqet fytyra e Zojës, e interpretuar nga Pietrina Mennea, e cila shtrihet mbi fytyrën e Jezusit të vdekur (Fiorenzo Mattu).

Zëri i Giuseppe d'Arimatea përfundon: “Zoti ka dashur kështu”. Fillon kështu filmi “Mbi Mbretin” (Mbreti), i realizuar nga Giovanni Columbu në vitin 2012.

Kryqëzimi

Përgjatë shkatërrimit të gurëve katrorë të periudhës neurologjike; mbledhet Sinedrini. Janë të moshuarit e fshatit. Në fytyrat e tyre lexohet lodhja dhe mosha. Rrudha të thella, faqe të gërmuara...

Kostumet janë të ngjashme me veshjet e punës, të vjetruara nga përdorimi, të veshura para disa dekadave nga fshatarët e moshuar dhe nga pastorët. Ndonjë forcë e blinduar nga hekuri për ushtarët romak. Ngjyrat: e gjelbër, ngjyrë ndryshku tullash janë harmonizuar me ato të peizazhit përreth.

Imazhe nga dokumentari ilustrojnë, pa trillim, fytyrën e Caifa (Tonino Murgia), në dorë mban një shkop, simbol i komandimit dhe i atyre që e ndjekin. Janë tutorët e urdhrit, të cilët në risinë e mesazhit të Jezusit, nuhasin një rrezik: përmbysja e zakoneve antike (mendore dhe praktike), nga të cilat zvarritet një ndjenjë sigurie.

Kamera kalon nga një fytyrë në tjetrën, i kontrollon; i analizon ndërsa në kolonën zanore dëgjohej, në gjuhën e Sardenjës, propozime të egra. “Ky është i rrezikshëm dhe duhet pasur frikë”. “Duhet eliminuar” “Ta lidhim duarsh dhe

këmbësh dhe ta mbysim” “Të skanohet dhe të hidhet në një gropë” “Le ta hanë” “Duhet ta helmojmë” “Jo! Përndryshe fryhet”. Ndryshim skene. Qiell i mbuluar me re. Është një subjektivitet nga poshtë lart të të gënjës Jezus, i cili i shtrirë në kryq, po shkon drejt kryqëzimit.

Trupi i Jezusit është trupi i një fermeri të mbledhur, krejt i kundërt me disa figura të dashura, të ngjashme me pikturën që shpreh sentimentalizëm dhe devocion.

Jezusi, duke shikuar lart vështrohet t'i afrohet figura masive e një farkëtari, i cili është duke e gozhduar mbi një kryq. Kamera i afrohet këtij trupi të këtij njeriu të pafuqishëm : një hije e zezë e cila qëndron kundër sfondit të bardhë.

“Kryqëzoje”!- është urdhri i prerë që dëgjohej. Por, punonjësi i detyrës mizore ekziston. Përkulet që të marrë në dorë çekiçin e rëndë. Kamera kap në detaje mjetin dhe vë në planin e parë fytyrën e punonjësit që do të kryqëzojë, i cili e vendos çekiçin në tokë ndërsa në kolonën zanore dëgjohej, gjithnjë në gjuhën e Sardenjës, zërat e atyre që e fyejnë dhe e përqeshin figurën e Jezusit.

“Nuk është biri i Zotit, pasi përndryshe do të ishte liruar”. “Afrohuni dhe shikoni”! Goditje çekiçi.

“Por çfarë Zoti është Zoti? Tallet me njerëzit”! “Krijon konfuzion, por nuk është askush”! “Nuk është aspak Mbreti”

Vazhdojnë goditjet e çekiçit. Lind një raport i çuditshëm mes butësisë së Jezusit, që i dorëzohet martirizimit dhe nga ana tjetër ndërgjegjja e vrarë e atij që bën një detyrë, të cilën e kupton që po ta bëjë do të dënohet në të ardhmen.

Kur shikimi largohet nga ambienti rrethues, kuptojmë që ndodhemi në një gurë të gjerë, ku njerëzit janë të shpërndarë këtu – aty.

Është Zoja e mbështetur tek Maria Madalenë dhe Maria di Cleofa. Në një vend të vetmuar, janë të pranishëm disa apostuj, të heshtur dhe të menduar... Duke ndjekur mendimet e tyre, kthehemi pas në kronologjinë e tregimit deri në mbrëmjen e ditës së kaluar darkën, te kopshti i ullinjve...

Përreth zjarrit

Apostujt që flenë në kopshtin e ullinjve. Rrezet



e një zjarri, të ndezura poshtë një grope, e bëjnë dikë që ishte fjetur të çohet i përgjumur. I kushtohet gjithnjë e më shumë vëmendje ushqimit të konsumuar së bashku.

Heshtje. Bie mbi grupin e miqve një hije mosbesimi dhe frike. Jezusi, i cili kërkon gjithnjë që të dalë nga “korniza”, sapo pati shqiptuar një frazë, por që nuk dallohet në film “Njëri nga ju do të më tradhtojë”.

“Mos do të jem unë?”- është pyetja që apostujt e përsërisin njëri pas tjetrit, në mënyrë ritmike.

Kamera, e cila tërhiqet mbi fytyrën e Jezusit, përqendrohet mbi fytyrat e apostujve. Spiunon ankthin e tyre. Merr nga pyetjet e tyre, pranimin e padyshimtë të një ndjenje të fajit kolektiv, përballë asaj që po ndodh.

Madje më shumë sesa për pyetjet e tyre, kamera përqendrohet mbi pauzat që pasojnë mes një pyetje dhe një tjetre. Vëmendja, në mënyrë të natyrshme, i drejtohet fytyrës së Judës. Pietro i thotë Gjoanit: “Pyete se kush është”. Giovanni pyet Jezusin: “Thoni se kush është tradhtari... Thojeni tani”.

Jezusi: “Është ai i cili është me mua...”Ky

dialog, i bërë me fjalë të varfra, tërhiqet nga momentet e heshtjes. Alternohen imazhet e atyre, që fjetën në tokë, në kopshtin e ullinjve.

Fytyra e Judës, në brendësi të gropës-darkë, kryqëzohet me imazhet në të cilat ai e shikon vetveten teksa largohet nga grupi për të shkuar që të bijë dakord me ato që e urrejnë për vdekje Mësuesin.

Ja në detaje duart e Jezusit, që marrin një copë qengji dhe ia ofrojnë Judës. Ai e çon kafshatën në gojë dhe e përtyp, por nuk mund ta kapërdijë.

Nga imazhet që pasojnë, fiksohet ajo e një dere që mbyllet pas shpatullave të Judës, teksa ai del në errësirë.

Dyshimet e Pilatit

Një grua e shtrirë në tokë mes degëve, gjendjet e tronditur nga ndëshkimi. Përballë saj, fytyra e Jezusit, ku kamera e ka fiksuar në profil, qëndron mbi kryq, ku ka disa orë që është i varur aty.

“Kam etje”!. Përreth shikohen fytyra të habitura. Ndonjë tallet nga larg. Dikush tjetër fyen.

Një spektator i pavëmendshëm mund të

mendojë se gruaja, e cila qan në këmbët e kryqit, është Zoja. Por nuk është kështu. Një vështrim më i kujdesshëm dallon që ajo është gruaja e Pilatit, e cila, ashtu siç thuhet në Ungjillin e Mateut, ka vuajtur shumë në gjumë për shkak se e di që Jezusi ishte ai i drejti. Kryqi, i cili ndodhej përpara saj, mund të jetë fryti i vizionit të errët që e ka turbulluar.

Një ushtar i pamëshirshëm fut një sfungjer në uthull, e lidh në një kallam dhe ia jep Jezusit.

Kaifa dhe ndjekësit e tij, shkojnë drejt Pilatit, i mësuar për të bërë shkatërrime mesjetare. Tërheqin zvarrë pas tyre Jezusin, të lidhur si një kafshë. Pilato (Paolo Pillonca): “Çfarë ka bërë ky djalë?”

Akuzuesit drejtohen drejt Jezusit: “Pse nuk përgjigjesh”? “Gënjeshtar”? Gra që qajnë të mbështetura në gra të tjera. “Thotë se është mbreti i judejve”. “Nëse do ishte i pafajshëm, do t’u mbronte”!

Në planin e parë, si sfond shfaqet fytyra e gruas së Pilatit. “Çfarë mund të bëja”? – shfaqësohet Pilati.

Gruaja e Pilatit: “Unë kisha thënë jo”. “Mbreti...” – i thotë Pilati gruas. “Fjalë e bukur kjo.. Nuk është as e kësaj bote...” Banditët e Kaifës i vendosin Jezusit mbi kokë kurorën me ferra, dhe i hellin në shpatulla një stof të kuq të ndezur, për “ta bërë” Mbret.

Pilati i propozon të pranishëmve që të lirojnë një të burgosur: Jezusin ose Barabën. Të gjithë brohorasin “Baraba!”.

Pilati: “Nuk dua gjak të pafajshëm mbi mua”. Kërkon që t’i sjellin një legen për t’i larë duart. Është dënimi shkaku, siç vihet re, e “*Rex ludaeorum*”, e thënë nga Pilati dhe e riafirmuar në mënyrë të prerë: “*Quod scripsi scripsi*”. Jezusi është i shpallur Mbret nga Pilati dhe është përqeshur kështu nga të tjerët.

Shkëputje. Jemi në gropën – e fundit. Në planin e parë qëndron Jezusi, i cili është i filmuar nga lart. Heshtje e gjatë.

Jezusi “Biri i njeriut po ik. Kështu ishte e shkruar për të”. Apostujt e dëgjojnë. “Ju jap një urdhër të ri... Ta doni njëri-tjetrin, ashtu siç unë ju desha juve... Kështu do të kuptojnë se keni qenë me mua...”.

Kemi arritur në zemër të filmit. Këtu kuptohet se çfarë ka dashur të thotë Jezusi kur fliste për

mbretërimin.

Re të ngjyrosura në qiell pas perëndimit. Është momenti i Eukaristisë. Edhe këtu kemi një respekt antipod ndaj ikonografisë tradicionale. Jezusi prapa saj, shpërndan bukë dhe verë. “Merrni, hani... Merrni, pini...”. Zjarri digjet në qendër të gropës.

Pietri dhe Juda, rrugë të kryqëzuara

Pietri, në kopshtin me ullinj, fle me sytë e hapur. Skena e mëparshme, e cila zhvillohet në gropën-e fundit, ka mundësi që të jetë fryt i rikthimit të së kaluarës. Shikon Jezusin sesi largohet në mesin e pemëve me ullinj dhe dëgjon zërin e lutjes së tij.

“Nëse do ishte mundësia... që të mos pish këtë kupë... Atë.”! Jezusi shikon drejt qiellit të mbushur me re grihe. Banditët afrohen, të drejtuar nga Juda: “Përshëndetje, Mësues!” “Për këtë ke ardhur”? Është udha e tradhtisë. Grindje mes banditëve që hidhen drejt Jezusit. Juda largohet shpejt nga skena e krimit, i shoqëruar nga kamera. Ndalet në këmbët e një peme dhe e shikon, por rrugëtimin të tij ende nuk i ka ardhur fundi. Jezusi, i arrestuar, çohet në Sinedrio. “Vendosini shkopin, ashtu siç e meriton”!

E hedhin në tokë dhe e rrahin. “Ku janë dëshmitarët”? Disa nuk kujtojnë, disa tregojnë gjëra të pasakta. Të gjithë janë fjalëpakë dhe të manipuluar. Kaifa është i pamëshirshëm. Asnjë shfaqje teatrore nga ana e tij. “Ti je Jezu Krishti?... A je Mesia?... Përse nuk e thua?...” Jezusi: “Jam unë”. Fytyra të egra. Shikime armiqësore. “Nuk është e vërtetë”. “Po blasfemon”. “Duhet të vdesë”!

I dënuar në një cep, larg vështrimit të kamerës, Jezusi i përqeshur si një profet i remë. Në oborrin e të njëjtës ndërtesë, Pietro tërhiqet nga shërbëtorët e Kaifës, rreth zjarrit. “Nga je”? “Më duket që të kam parë një herë tjetër”. Shkëndijat që bien nga zjarri, bëjnë një kërcim të zymtë përballë fytyrës së trembur të Pietros. “Ishe me të”. “Po më ngatërroni me dikë tjetër”. “Je vërtetë ti”. “Ishe me atë një ditë përpara”.

Mes të pranishmëve është edhe Malco, të cilit Pietro ia ka prerë veshin... Është e kotë që ta fshehësh. E kotë që ta mohosh.

Pietro betohet dhe stërbetohet se nuk e ka njohur kurrë Jezusin.

Ndërsa po tentonin që ta kapnin, Pietro arrin që të

largohet dhe ik krejtësisht i vetëm, duke ndjekur pak a shumë të njëjtën rrugë, që kishte bërë Juda në pyll.

Rruga e dhimbshme

Në këtë pikë duket sikur filmi ndryshon fushë. Çfarë ka ndodhur? Drita e udhëhequr nga dielli, që deri në këtë moment ishte i mbuluar nga retë, i mbuluar nga hijet e mbrëmjes, madje i gëlltitur nga errësira e natës, i shqyer nga flaka e zjarrit... Drita e diellit, që lind mes reve në mes të ditës, shfaqet papritmas në qiell... Rrezet e tij përshkojnë gurët e mprehtë, që formojnë shkëmbin e hidhur.

Filloi rruga e kryqëzimit, Jezusi pengohet poshtë peshës së kryqit.

Nga drita verbuese e diellit që ka ndriçuar shkëmbin, kalohet në hijen e thellë që ka rënë në kopshtin e Pretorios. Është një nga kapërcimet e shpeshta të retrospektivës, që është karakteristikë e këtij filmi. Skena e parë më lart, e dënimit, është përcjellë me ngadalësimin e kohës dhe heshtjeve të zgjatura. “E kam dashur”- është përgjigjja përfundimtare e Pilatit ndaj lotëve të së shoqes.

Fytyrat e atyre që kërkojnë vdekjen e Jezusit janë të vendosura. Kanë mbi to diçka që e parashikon vetë vdekjen, të kërkuar me insistim dhe gati të shijuar me dëshirë.

“Nëse është i pafajshëm, gjaku i tij të bie mbi ne dhe mbi fëmijët tonë”. Frazja përsëritet, përmes intervalit të pauzave të gjata, nga njëri komandant në tjetrin, të Pretorios. Asnjë nga do që t'i shmanget përgjegjësisë të veta. Jemi edhe një herë në zemër të filmit. Zemra e ndritshme i përkiste një komandimi të ri, atij urdhërimi që Jezusi i jep apostujve, i shoqëruar nga ritet e Eukaristisë. Filmi, e vendos theksin tek ritet e këtyre gjesteve të përsëritura, ashtu siç kishte bërë herës së parë, kur në dreqën e fundit, u perceptua ndjenja e përgjegjësisë së apostujve kundrejt tradhtisë.

Le t'i kthehemi Kryqëzimit, përsëri në diell. Jezusi është i rraskapitur. Refuzon që të pijë pijen, që i ofrohet. Goditje thikash. Janë hajdutët ato që kryqëzohen me vuajtje të paimagjinueshme. Ato të dy nuk pushojnë së shari njëri-tjetrin.

Zojën e largojnë, që të mos shohë aspektet më brutale të kryqëzimit të të birit.

Figura të shpërndara në shkëmbin e pushtuar nga dielli.

Pietro, përmes një prezence të heshtur, ndjen një gulçim krenarie të thyer. Pendohet që e ka refuzuar

Jezusin. Ngrihet në këmbë dhe bërtet me të gjithë zërin që ka: “Ai është një shok i imi... A e kuptoni?... Isha me të natën e kaluar... Unë jam njëri nga to...”.

I ndryshëm është rasti i Judës. E gjejmë afër pemës ku e kishim lënë. Pastaj në Sinedrio, për t'i kthyer paratë “e ndyra me gjak”.

Edhe një herë Juda, pranë pemës, mendueshëm. Rijeton një çast nga darka e fundit, përpara se atmosfera të errësohej në peshën e dyshimit dhe frikës. Është momenti kur apostujt, bashkë me Mësuesin e tyre, e ndajnë zonën më të ngrohtë të cepit dhe na mësojnë se sa mirë është t'i shijosh çastet në shoqëri të mirë... Nga buzëqeshja e pavetëdijshme e jetës së Judës (kur akoma mund të shpëtonte...)- në trupin e tij që qëndron i palëvizshëm nga pema.

Afrohet ora e vdekjes së Jezusit, e vendosur në planin e parë të filmit, gjithnjë mizore në limitet e durimit.

Detaj i veçantë është që në fytyrën e Jezusit duke vdekur i afrohet fytyra, që ai pati në darkën e fundit. E gjithë dashuria dhe dhimbja përqendrohen në këto dy imazhe, të cilat pasqyrojnë njëri-tjetrin.

Edhe një herë qielli bëhet me re.

Zoja shikon me intensitet të birin, i cili frymon për herë të fundit. E kujton veten, gati fëmijë, me birin e saj në krah, Jozefi, dhëndri i ri, afër saj. Tre Magjistarët që ofrojnë dhuratat e tyre... Njerëzit të shpërndarë largohen nga vendi i kryqëzimit. Vjen Longino mbi kalë. Me shtizë shpon të shtrenjtin Jezus, tashmë të vdekur. Jozefi i Arimateas i kërkon Pilatit që të mund të varrosë Jezusin. “Kush je”?

“Një mik” Zoja përqafton trupin e Jezusit, akoma përpara sesa ai të rrëzohet nga kryqi. T'i rikthehemi skenës së parë të filmit, me Zojën, e cila me lotët e saj hedh trupin e Jezusit në gropë.

Jozefi i Arimateas citon Isainë: “Pas shumë dhimbjeje, ai fillon të ndriçojë dhe me të e gjithë bota”. Imazhi i fundit i filmit e prezanton Zojën dhe Shën Jozefin, të dy të ri, së bashku me Jezusin fëmijë, pak të rritur, të cilët vrapojnë shkëmbit, të tre të shëndetshëm dhe të lirë, pasi i kanë shpëtuar duarve të ushtarëve së Erodes.

Materia i përkthyer nga revista kulturore –

fetare: Giovanni Columbu,

“La civiltà cattolica”.

Përktheu: Benardina Shahini

**KISHA 900-VJEÇARE E SHËN GJONIT NË RUSHKULL - GRUEMIRË,
DIOQEZA E DRISHTIT
DËSHMI E TRADITËS SË KAHERSHME KATOLIKE**

Rrënojat e një Kisha apo Manastiri që shohim sot në afërsi të fshatit Hysaj (Gruemirë), dikur janë njohur si një ndër objektet e rëndësishme të qytetërimit e besimit Krishterë (Katolik). Këtu dikur sipas gojëdhënave e dokumenteve të ndryshëm ka qenë Kisha e Shën Gjonit, (Shën Gjinit) ku shpesh për nga madhësia e ndërtimit e veçanërisht e funksionit që kryente quhej Abacia i Shën Gjonit, dhe i përkiste urdhrit Benediktin. Një historian i njohur i Kishës, shkruan se vepra e Ungjillëzimit ka njohur... zhvillimin dhe ekuilibrimin e vet të plotë në shekullin e VI më "Benediktinet"... Rregulla (e tyre) bazohej në thënien : "Ora et Labora", që nga latinishtja përkthehet; Lutu dhe Puno. Nga historia mësojmë se pranë çdo manastiri apo abacie të urdhrit benediktin duhej të themelohej një shkollë për shërbime Hyjnore. Ndaj mendojmë se edhe në Manastirin Benediktin të Shën Gjonit, duhet të ketë pasur ndonjë shkollë të tillë.

Sipas dokumenteve që gjenden sot, Kisha apo Manastiri i Shën Gjonit ka një moshë rreth 900 vjeçare. Pikërisht për një moshë kaq të madhe "tregon" konsulli italian Ermanno Armaos, duke folur në librin e tij "Vende, Kisha, Lumenj në Shqipëri. Për të konkretizuar këtë në nga faja 140 e librit po "citojmë" :... Kisha dhe kuvendi të shpien në kohë të largëta. Një dokument i parë i vitit 1166 përmend abatin e kishës Sancti Johannis (Shën Gjonit në Rash të Poshtëm). Abacia gëzonte sipas kohërave mbrojtjen e princërve.... dhe (më vonë) të Republikës Venedikasve..." Albanologu kroat Milan Shyflay shkruan se në këmbët e malit të Maranaj, në fushën e Shtojit (Strilaleo) ishte abacia e Shën Gjonit... (Serbet dhe Shqiptaret fq.211).

Citime të tilla gjejmë edhe nga studiues, albanologë, historianë e shkencëtarë të tjerë. Gjithsesi duke ditur se trevat Ilire përqaftuan që në shekujt e parë besimin e Krishterë në mendojmë se pavarësisht dokumenteve që kemi Kisha e Shën Gjonit si objekt kulturi duhet të kenë qenë shumë më e hershëm, pse jo të mos mendojmë se ajo ekziston të paktën që pas vitit 518, kur një termët i fuqishëm kishte goditur Qendrën Historike të qytetërimit e besimit krishterë Dioklen (sot territor i mbetur nën republikën e Malit Zi që nga viti 1878). Sidoqoftë në po ju drejtohem disa dokumenteve të tjera të cilat vërtetojnë historinë e Kishës së Shën Gjonit:



Së pari një dokument që gjendet në arkivin e Vatikanit dhe i përket vitit 1356 në të cilin shkruhet se Ipeshkvi i Balesiumit (Balleza Rrjoll) merr si dhuratë Manastirin Benediktin të Shën Gjonit në Rrash... pasi pas vdekjes së abatis të fundit Andreas ai ka mbetur vakant.

Së dyti një dokument i Senatit Venedikas i datës 7 maj 1403, i cili tregon se liron nga të dhjetat tokat e Abacisë së Shën Gjonit. Së treti përsëri një dokument i Selisë së Shenjtë i datës 16 shtator të vitit 1445, i cili përmban të dhëna mbi juridiksionin e abacisë së Shën Gjonit... duke e përcaktuar në distriktin e Drivastros (Drishtit të dikurshëm). Së katërti një letër e Papa Piu II të vitit 1459 drejtuar Ipeshkvit Manuel të Shkodrës, nga e cila mësojmë se abati i Manastirit të Shën Gjonit ishte shqiptari

Pjetër Ksavon (Csavon)... Të gjitha keto dokumente gjinden të pasqyruara edhe në librin “S H Q I P Ë R I A E V J E T E R” ... fq.249-250, të studiuesit Theodor Ippen, konsulli i Perandorisë Austro-Hungareze në Shkodër në vitet 1897 – 1904. Është interesant se gjatë shekullit 17-të, Kisha e Shën Gjonit është objekt i shënuar edhe në shumë Harta të kohës duke e shënuar herë si Kishë e herë si Manastir e tjerë... Një ndër hartografët e hershem që shënon në hartat e shekullit 17-të kishën apo manastirin e Shën Gjonit është hartografi italian At Vincenzo Koronëli, (i lindur në vitin 1650). Për Kishën e Shën Gjonit studiuesi (dhe konsullit francez në Shkodër) DEGRAND në librin “Kujtime nga Shqipëria e Epërme”(fq.49-50), pasi bënë identifikimin më data dhe vite shkruan se kjo Kishë ka të paktën një moshë mbi 700 vjeçare, duke e përshkruar gjendjen aktuale : “...Mbeturina muresh rrethojnë vendin në mes të cilëve ngrihet një Kullë. Ndërtesa duhet të kishte qenë e rëndësishme në përpjesëtim më përmasat e kullës që ende sot (fundi shek. XIX-të) është e gjatë 35 metra dhe e gjerë 4.5 metra. Këto rrënoja janë gjithçka ka mbetur nga manastiri i vjetër i Benediktinëve...Ku sipas dokumenteve thuhet se disa herë kjo kishë është shkatërruar nga serbet gjatë shekullit të 14-te...” Materiale historike të rëndësishme paraqiten nga studiuesja shqiptare Nevila Nika në librin: “Dioqeza e Shkodrës gjatë shekullit XVIII, sipas dorëshkrimeve arkivore”. Në faqen 155, nga dokumenti nr. 8 i vitit 1745, ndër të tjera mësojmë se : “.... Rrashi kishte 10 shtëpi katolike të fshehta më 38 frymë. Kisha Abaciale ishte nën bekimin e Shën Gjon Paguesit, është ndërtesë madhështore, u përket Etërve Benediktin.

Terrenet e sajë thuhet se zotërohen nga Otomanët. Ka pranë një pus uji të thellë, kisha dhe kuvendi janë vendosur në një pllajë të bukur...” Historia e Kishës apo Manastirit të Shën Gjonit ka kaluar përmes shumë dallgëve që solli jo vetëm pushtuesi shumëshekullor otoman, por edhe fqinjët jabanxhi sllav, që mikpritjen e malësoreve shqiptarë u munduan ta shfrytëzojnë për qëllime shovenë. Studiuesi i njohur Theodor Ippen përshkruan një “moment” të tillë që kanë si fillim vitet 1820-1830, kur në zonat për-rreth Kishës së Shën Gjonit kishin ardhur emigrant nga Spija (afër Tivarit) i Malit Zi, që atëherë ende ndodhej nën



juridiksionin e pushtuesit Otoman. Refugjatët ortodoks kishin ardhur nga Mali i Zi për arsye gjakmarrje apo varfërie...në vitet e para të shekullit 19-të. Për arsye se këta ortodoks ardhacak nuk kishin Kishën e tyre dhe për rrjedhojë varret deri në vitin 1857, Malësorët katolik i kishin lejuar ortodokset të varrosnin të vdekurit e tyre në varrezat katolike përreth kishës së Rrashit (meqenëse edhe feja ortodoks ishte Kristianë). Mirëpo në vitet 1859 dhe 1869 ketë bujari të malësorëve Katolik u munduan ta shfrytëzojnë për qëllime shoviniste Serbo-Malazezët, të cilët nxiten komunitetin e vogël në numër (të Vrakes), për të pretenduar se Kisha e Shën Gjonit dhe varrezat përreth janë të ortodokseve jabanxhi dhe jo të katolikeve Vendali. Natyrisht malësoret ishin pushkë e ngrehur për të mbrojtur më çdo çmime ketë objekt besimi e qytetërimi shumëshekullorë. Në vitin 1869 Valiu i Shkodrës për të shmangur një konflikt të mundshëm në mes Katolikeve dhe Ortodokseve “Ndaloi” pronësinë e Kishës së Shën Gjonit për Komunitetin Katolik dhe e shpalli pronë të shtetit... (Th. Ippen “Shqipëria e Vjetër”, fq.250-251).

Ky vendim i pushtetit të kohës i kushtoi jo pakë këtij monumendi, pasi shumë gurë e pllaka më mbishkrime historike u grabiten për të ndërtuar shtëpi apo diçka tjetër nga banoret përreth... Një studiues tjetër francez (edhe ky konsull i Francës në Shkodër, mesi i shekullit 19-të) Hyacinthe Hecquard në librin “Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë se Epërme ose Gegërisë”, në faqet 157-158, shkruante se: “..Kisha e vjetër e Rashit, e ndërtuar pranë fshatit Vrak u përket Katolikeve të Koplikut, çdo vit ditën e Shën Gjonit aty vijnë njerëz për pelegrinazh dhe marrin pjesë në meshë... Gjithashtu ky studiues përshkruan hollësisht organizimin e malësorëve katolik për mbrojtjen e Kishës nga pretendimet e komunitetit të vogël ortodoks në vitin 1855. Ortodokset sipas Hekardit

kishin ardhur nga Mali i Zi rreth 30 vite para pretendimeve në Vrakë.

Pretendimi për pronësinë e Kishës së Shën Gjonit shkruan Hekuardi, kishte ardhur nga ortodokset e Shkodrës dhe Peshkopi i Prizrenit, që asokohe gjendej në këtë qytet. Preteksti për të kërkuar këtë vend të shenjtë ishte se sipas tyre kjo kishë kishte qenë e stilit Grek (Ortodoks) dhe ndërtimi datonte më kohën e perandorëve serbe... Më tu përhapur ky lajm në male, koplikasit, të cilët prej më shumë se një shekulli varrosnin të vdekurit e tyre (në varret aty afër) ju bashkuan edhe malësorët e tjerë. Rreth treqind vetë zbriten në fushe duke marrë më vete edhe një Prift, i cili në prani të tyre Shenjtëroi edhe njëherë Kishën e moçme sipas ritit latin dhe mbajti aty një meshë. Meqenëse kjo çështje mund të bëhej serioze dhe mund të përfundonte më rrënimin e fshatit sllav, Peshkopi Katolik dërgoi një promemorie në Stamboll, ku dëshmonte falsitetin e pretendimeve të ortodokseve më anë të dokumenteve të pakontestueshme... (Hyacinthe Hecquard; "Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë", fq.157-158). Sidoqoftë "rrënojat" e Kishës së Shën Gjonit mbijetuan, madje për dekada më rrallë këtu u zhvilluan pelegrinazhe të njerëzve të ndryshëm që shpesh herë gjeten prehje shpirtërore e mrekulli hyjnore që mund ti bënte vetëm Shën Gjon Pagëzori i cili njihet si një ndër Paralajmëruesit dhe pagëzuesit e vetë Mesisë, Jezu Krishtit... Është interesant të thuhet se megjithëse kanë kaluar shekuj dhe furtuna, Rrënojat e Kishës

apo të Manastirit të Shën Gjonit, sot në afërsi të fshatit Hysaj (të Komunës Gruemirë të Malësisë Madhe) jo vetëm janë ruajtur pa i mbuluar harresa, por ato sot kanë filluar të bëhen vend pelegrinazhi, i shumë banorëve të Malësisë e më gjerë, ku në këtë vend të Shenjtë kërkojnë të gjejnë derman shpirtërore e fizik, për të përballuar dallgët e jetës, dallgë të cilat edhe në fillimet e shekullit XXI u munduan ti aktivizojnë fqinjët e vonshëm Sllav. Por pretendimet e sllaveve ortodoks tashmë ngjajnë mjaft donishoteske, pasi historia sot lexohet e jo imponohet si dikur. Në para disa kohëve mësuam një fakt interesant, pasi sipas disa banorëve në vitin 2004 "dikush" ka bërë gërmime në themelet e këtij Manastiri, ku janë gjetur të gdhendura në gurë truporet e Jezu Krishtit dhe Zonjës Marie, të cilat janë marre nga të interesuarit, që sipas thënieve (të banorëve për-rreth) janë të institucioneve fetare apo shtetërore. Tashmë në këtë Kishë-manastir janë bërë disa rikonstruksione nga Kisha katolike e Shkodrës, por ende të pa mjaftueshme, për të ruajtur nga ky monument, besimi e qytetërimi atë çfarë mund të ruhet. Gjithsesi në shpresojmë që rikonstruksioni të vijojnë.. pasi kujdesi dhe mbrojtja e monumenteve të tilla që rrezatojnë qytetërim e besim perëndimorë, janë jo vetëm një detyrim i shtetit shqiptarë, por edhe i vet shqiptarëve, pasi kështu dëshmojmë historinë tonë të pa kontestueshme Evro-perëndimore.

Gazeta: Malesia, 2016.



ISLAMIZIMI I SHQIPTARËVE SIPAS PROF. GEORG STADTMÜLLER (1908-1985)

(Pjesa e dytë)

* **Georg Stadtmüller (1909 - 1985)** është njohës i mirë i historisë së shqiptarëve. Ka shumë publikime mbi historinë e shqiptarëve, sidomos është i njohur libri i tij *"Forschung zur Albanischen Frühgeschichte (Kërkime për historinë e hershme shqiptare)"*. Ai ishte edhe profesor në Mynih (München) në „Institut Geschichte Osteuropas und Südosteuropas an der Ludwig-Maximilians-Universität“. Ky punim është botuar në: *Jahrbücher für Geschichte Osteuropas, 1955, Bd. 3, fq.404-429, München/Mynih me titull „Die Islamisierung bei den Albanern“*.

4. Shtrirja e mëturjes dhe islamizimit deri në mbarim të shek. XVII Parashikimet e errëta të argjipeshkvit Bizzi se në shtatë vjetët e ardhshëm edhe të krishterët e mbetur po ashtu do të kalojnë në islam nuk u realizuan. Mirëpo „turqizmi“ në dhjetë vjetët e ardhshëm mbërthehet fuqishëm. Një pamje të vështirë të rrethanave kishtare na jep një relacion i vitit 1621. Në atë kohë argjipeshkvia e Lezhës mbetet jetime për njëmbëdhjetë vjet. Françeskanët, të cilët e marrin përkujdesjen shpirtërore (puna pastorale) në këto famulli, ndërsa ia lejonin vetës lloj-lloj të drejt edhe përparimi, kishin kundërshtuar urdhrin e vikarit gjeneral të ipeshkvisë së tyre dhe bile fizikisht kishin keqtrajtuar. Argjipeshkvia e Lezhës në atë kohë u nda në tri pjesë: në rajonin bregdetar, rajoni „Ultra

Montes“ (Dibra) dhe rajoni „Intra Montes“ (Mati). Në pjesën bregdetare rrethanat kishtare deri në një masë ishin të kënaqshme. Gjendja shumë e keqe ishte në pjesën e Dibrës. Atje nuk kishte fare klerikë. Populli ishte lënë plotësisht jashtë dore dhe kishte humbur plotësisht marrëdhëniet e brendshme me jetën kishtare, u kishin mbetur vetëm emrat e krishterë. Kishat e atjeshme krahasoheshin me strofullit e hajdutëve. Rajoni „intra montana“ ishte shkretuar plotësisht nga hajdutët e përhershëm. Kishat ishin shkatërruar. Jeta kishtare është shuar. Në atë kohë ngjashëm ishte edhe në famullitë tjera. Në vitin 1623 rrethanat kishtare edhe në argjipeshkvinë e Shkodrës ishin në rënie të plotë. Firmani i Sulltanit, që i jepet argjipeshkvit Marino Bizzi në vitin 1609, nuk e kishte dhënë mbrojtjen e popullatës së krishterë nga in toleranca turke për të ardhmen. Në periudha të caktuara kohore edhe priftërinjtë e krishterë bien viktimë e in tolerancës turke. Kështu në vitin 1624 prifti i zellshëm Markus nga Chisagnio, nga një fshat i cili sot nuk ekziston më, burgoset dhe pasi që ai refuzon kalimin e tij në islam vritet. Kufoma e tij, mbas një pagese që kishin dhënë besimtarët e tij për nxjerrjen e saj, varroset në famullinë e vendlindjes. Në vitin 1630 për habi të tij kishte vërejtur vizitatori klerik se në fshatin Vilesa në rajonin malor të Drinit gjysma e popullsisë kishte kaluar në islam. Mu në ato vite

islamizimi kishte depërtuar fuqishëm. „Turqizmi“ ishte bërë një dukuri e zakonshme, të „turqizuarit“ më nuk mënjanoreshin nga katolikët e mbetur besnikë. Vizitatori pohonte se të krishterët dhe renegatët jetonin së bashku në një shtëpi e në një familje. Mirëpo në brendinë e Malësisë së Shqipërisë Veriore islami në atëkohë nuk kishte shtrirje që ia vlen të përmendet. Një relacion i vitit 1634 përshkruan ipeshkvin e Pultit.



Popullata e kësaj krahine kodrinore numëronte më shumë se 20.000 shpirtra të krishterë. Pasi që në tërë rajonin janë vetëm dy priftërinj, ku njëri prej tyre për shkak të moshës vështirë e kishte të lëvizte, kanë bërë që disa të krishterë në një numër të vogël të kalojnë në islam. Ky fis përbëhej prej luftëtarëve trima Sasë 'thuhet, të cilët para pak muajsh sanxhakut turk, që kishin pasë dashur ta vënin nën kontrollë këtë rajon, ua kishin shkaktuar një humbje me përmasa shkatërruese. Për religjionin dhe sendet religjioze ata dijen vërtet pak, mirëpo ata i qëndrojnë besnikë krishterimit. Në rajonin e Kosovës popullata e imigruar shqiptare qëndronte në besimin katolik.⁵¹ Tërë ky rajon i takonte argjipeshkvisë së (An)Tivarit. Një pjesë e madhe e popullsisë e këtij rajoni ishte ortodokse dhe ishin nën patriarkun serb të Pejës (Ipek). Në atë kohë një pjesë e madhe e popullsisë shqiptare ishte detyruar të kalojë në islam. Në qytetin e Prizrenit kishte 12.000 muhamedanë („turq“), gati të gjithë me prejardhje shqiptare, përveç këtyre kishte vetëm 200 katolikë dhe 600 ortodoksë. Më herët në fushat përreth shumë fshatra kishin qenë katolikë, mirëpo për shkak të mungesës së priftërinjve edhe trysnive turke kishin kaluar në islam. Nga e njëjta arsye brenda katër vjetëve në 200 fshatrat e krahinave malore të Shqipërisë Veriore diku 2000 shpirtra kishin kaluar në „sekte osmane“. Ata priftën të pakët që janë, janë aq të pashkolluar sa që shumë pak e dijen alfabetin. Prandaj detyrë e madhe në të ardhmen është – këtë e thekson vizitatori në raportin e tij shkoqur – rritja dhe edukimi i priftërinjve në mënyrë të planifikuar.

Qyteti i Shkupit është i banuar nga pjesa më e madhe me muhamedanë e që shumica ka prejardhje shqiptare. Katolikë janë 17 familje me 50 shpirtra. Në Kratovë janë 40 shtëpi katolike me diku 160 shpirtra, në Karadak - Mali i Zi i Shkupit, diku 4000 katolikë. Novobërda është e banuar nga muhamedanët, serbët dhe katolikët (400 shpirtra), Jagnevo (Janjeva) prej muhamedanëve dhe serbëve. Përveç këtyre atje janë edhe 400 katolikë. Në rajonin e Prishtinës jetonin muhamedanët,

serbët si dhe nja 100 katolikë. Para një kohe të shkurtë kanë imigruar nga Shqipëria edhe 10 familje tjera katolike. Trepça ka 50 familje katolike me më tepër se 200 shpirtra. Procopoe (Prokoplje) disa familje katolike shqiptare, në Jagodno 10 shtëpi katolike. Interesant është një shënim mbi raportet gjuhësore: Katolikët e Prizrenit flisnin shqip dhe sllavisht ndërsa nëpër fshatra flisnin vetëm shqip. Fati i kishës katolike në të gjitha këto pjesë ishte i lidhur ngushtë me raportet politike mes Perandorisë Osmane dhe fuqive katolike fqinje. Në përgjithësi ipeshkvijtë katolikë përpigeshin të qëndrojnë jashtë politikës. Mirëpo në vitin 1645,



pas shpërthimit të luftës venediko -turke në Kretë(1645-1669), ipeshkvijtë katolikë të Durrësit, Shkodrës dhe Lezhës të nxitur nga argjipeshkvi i(An)Tivarit, të kurdisin një komplot politik në favor të venedikasëve, me qëllim që venedikasit ta marrin, ta kenë në dorë qytetin e Shkodrës. Plani zbulohet dhe dështon. Kjo ka qenë një arsye e re e mëtutjeshme për përndjekjen e popullsisë katolike. Argjipeshkvijtë e Shkodrës dhe Sapës ishin detyruar të iknin në territorin venedikas, për t'iu shmangur vdekjes. Dy françeskanë, Ferdinandi nga Abbisola dhe Jakobi nga Sarnano, që trimërisht qëndruan në Shkodër, i ngulën në hu të gardhit me urdhërin e pashait, ngase ata e kishin refuzuar kalimin në islam.

Popullsisë katolike i rritet shtypja tatimore dhe të gjitha dredhirat e ndryshme administrative. „Turqizimi“ e merr një vrull rishtas të madh. Shumica i shmangen „turqizimit“ me ikje. Kështu 3000 shqiptarë katolikë ikin në rajonin e Venedikut fqinjë (Dalmacinë Jugore), që t'i largohen shtypjes. Rreth kësaj kohe – kah mesi i shek. XVII - lëvizja e kalimit (në islam) kishte marrë përmasa të mëdha. Në Shqipëri numri i katolikëve duhej të kishte ra prej 350.000 në 50.000. Sipas një relacioni të vitit 1648 në atë kohë në pjesën bregdetare të Zadrimës kishin qenë 1000 shtëpi, 700 prej tyre të krishtera, të tjerat myslimane. Ortodoks kishin qenë vetëm disa shtëpi, të cilat me ndikimin e ipeshkvit katolikë kalojnë në katolicizëm. Në të njëjtin vit 1648 qyteti i Ulqinit (Dulcigno) ishte gati i tërë përfundimisht mysliman. Nga qyteti depërtoi islamizmi nëpër fshatrat e rrethinës. Në rajonin e atjeshëm bregdetar të „Markoviqëve“ („Markovići“) kishin „reneguar“ të gjitha fshatrat. Rreth të njëjtës kohë islamizmi kishte përfshirë gati gjithë rajonin e Durrësit. Një relacion për një vizitë që ka të ngjarë se kishte ndodhur pak vite pas vitit 1640, e tregon këtë në mënyrë shumë të qartë. Qyteti i njohur ishte dobësuar shumë. Kishat ishin shndërruar në gërmadha, pjesërisht ato ishin prishur nga ndikimi i motit e pjesërisht nga hidhërimi shkatërrues turk. Vetëm disa bashkësi kishtare kishin mbijetuar. Këto bashkësi kishin një numër të vogël të besimtarëve. Shumë bashkësi kishin kaluar në islam, dhe vetëm në 50 vjetët e fundit. Tani më e 100-ta pjesë e popullsisë nuk ishte e krishterë, dhe ishte për tu frikësuar – kështu thotë vizitatori – që edhe ata pak të mbetur që qëndronin ende në krishterim, do të heqin dorë po ashtu brenda 10 viteve. Po kështu islami tashmë ishte në epërsi në ipeshkvijtë e Krujës, Lisia (Lezha), Benda dhe Albanum, pra në ato krahinat malore të Shqipërisë Qendrore. Në luginën e Drinit të Zi (ipeshkvia Canova) islami ishte zotërues i vetëm. Njëkohësisht islamizimi kishte depërtuar edhe në pellgjet e Shkodrës. „Turqizohen“ fshatra të tëra, për t'i ikur ngarkimeve të padurueshme tatimore.

Po ashtu keq ishte edhe me ipeshkvijtë sufragane të Durrësit. Në Krujë ishte zhdukur ish kisha ipeshkvore, ndoshta ajo është djegë nga turqit. Në shumicën e fshatrave të ipeshkvisë së Krujës veç në atë kohë shumica e popullsisë kishte kaluar në islam. Ngjashëm qëndronte edhe ipeshkvia fqinje Lisia (Lezha), që përfshinte krahinat malore si Mirditën dhe Matin. Edhe këtu pjesa më e madhe e popullsisë kishte kaluar në islam. Të njëjtën pamje jepnin edhe ipeshkvijtë jugore

Benda dhe Albanum (Elbasani). Kisha ipeshkvore në Elbasanishte shkatërruar nga muhamedanët. Popullata e qytetit përbëhej tani vetëm prej myslimaneve dhe ortodoksëve „grekë“. „Grekët“ ishin armiq të edhe më të mëdhenjtë të katolikëve se „turqit“. Edhe më keq ishte në ipeshkvinë Canova (Dibër), që përfshinte pellgjet e Drinit të Zi. Në tërë ipeshkvinë nuk ishin 350 katolikë, ndër ta as 40 burra. Një relacion tjetër i vitit 1648 na jep një pamje për përbërjen e ipeshkvijve sufragane të veçanta të provincës kishtare të Durrësit. Pastaj në atë kohë në rrethin metropolitar të Durrësit kishte 25 famulli me 2520 shpirtra, në ipeshkvinë Canova 23 famulli (600), në ipeshkvinë Albanum (Elbasani) 17 famulli (3610), në ipeshkvinë Benda 17 (2988), në ipeshkvinë e Krujës 23 famulli (3.863), në ipeshkvinë Lisia 28 famulli (11.606).

Rrethi metropolitar i (An)Tivarit në atë kohë kishte vetëm edhe 5000 katolikë. Në Spizza (Spiç) pjesa më e madhe e popullsisë kishte kaluar në ortodoksi. Është me vlerë të madhe për njohuri tona mbi gjendjen kishtare në Shqipëri në mesin e shek. XVII një relacion i misionarit Francesco Leonardi të vitit 1648. Në përgjithësi këtu përshkruhet gjendja në Mal të Zi (Zenta). Popullata që numëronte mbi 80.000 shpirtra, i takonte ritit serbo-ortodoks. Një entuziazëm kishtar atje nuk vërehet. Vetëm agjërimet e parashikuara i kryenin në mënyrë të rreptë të pabesueshme. Sikur të kishte pasur misionarë të përshtatshëm, mirë do ta kishte fituar popullatën për një union kishtar. Në Mal të Zi ka disa katolikë si fisi Kelmendi dhe Gruda që se ishin pa prift. Argjipeshkvia fqinje e (An)Tivarit është e rrethuar nga ortodoksët. Me ndikimin ortodoks shkrihet popullata katolike.

Qyteti i Shkodrës është i banuar nga pjesa e madhe e të krishterëve. Ipeshkvia me 20.000 shpirtra ishte pa ipeshkëv. Prandaj tashmë në vijën bregdetare të Markoviqëve (Markovići) janë turqizuar fshatra të tëra. Në argjipeshkvinë Sfocia (Shasi) e bashkuar me ipeshkvinë fqinje të Shkodrës, fshatra të tëra nga shtypja tatimore turke kalojnë në islam; ngjashëm ishte edhe me ipeshkvinë e Ulqinit (Dulcigno), e cila ishte po ashtu e bashkuar me Shkodrën; qyteti tashmë ishte përfundimisht mysliman. Nga qyteti islamizimi depërton edhe nëpër vende përreth. Banorët e krishterë kalonin në shërbim të zotërinjve turke dhe humbnin fenë e krishterë.

**(Përktheu nga gjermanishtja:
Zef AHMETI)**

MESHA TRADICIONALE NË RRËNOJAT E ABACISË BENEDIKTINE E SHEK . XII. NË RRUSHKULL - MALËSIA E MADHE

Më kontributin e Arqipeshkvisë së Shkodrës dhe angazhimin e plotë të famullitarit të Boriçit, Atë Antonio Bozzi, në vitin 2012, është restauruar Kulla Qendrore apo kambanorja e abacisë Benediktine e shek. XII., dhe është sistemuar ambienti për shtegtaret që vijnë vazhdimisht për ta nderuar Shën Ndoun, dhe rrënojat e kësaj abacie kushtuar Shën Gjinit (Shen Gjinit).

Abacia e Rushkullit (Rashit) si dhe ajo e Shirqit buzë lumit Buna, janë gjurmët më të dukshme të prezencës së urdhrit të Benediktin në trevat shqiptare që në shek. e VI, duke përhapur krishterimin dhe kulturën Iliro - Arbërore në këtë pjesë të Arbërisë së hershme më thënie: Ora et Labora (Lutu e puno).

Rrënojat e sotme janë dëshmi e shumë furtunave historike më të cilat në të kaluarën u ballafaquan arbërorët më ato më Serbe, gjatë shek. XII-XIV dhe pushtuesve Osman për gjatë 450 viteve më radhe. Gurët e shpërndarë përgjatë këtij ambienti, tregojnë forcën e shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve të cilët asnjëherë nuk u molisën duke mbrojtur dinjitetin dhe identitetin e tyre fetare dhe kombëtar kundrejt armiqve që tentuan ta zhbijë atë nga faqja e dheut.

Duke vlerësuar rolin e çmuar që ka luajtur kjo abaci Monument Kulture, besimtarët e zonës të përkrahur nga famullitari Atë Antonio Bozzi, në vitin 2004 e kanë ringjallur këtë vend të Shenjtë duke organizuar zyrtarisht shtegtime për gjatë 13 të martave të Shën Ndout më celebrimin e Meshës së Shenjte.

Në shenjë përkrahje të besimtarëve nga Malësia e Madhe dhe rrethina e Shkodrës, për këtë iniciativë fisnike, me 12 qershor të këtij viti, Dom Nikolin Toma dhe Dom Nikë Ukgjini, bashkë me bashkëvëllezërit e urdhrit dehonjan, në rrënojat e kësaj abacie celebruan Meshën Shenjte.





Rinush Idrizi

NDRE MJEDA

Onufri,
Tiranë 2017



Dom Lush Gjergji

VIRGJËRA MARI

Drita - FH
Prishtinë 2016



Gjystina Cacaj - Shushka

Gruaja

Drita
Prishtinë, 2018

KUMBONA E SË DIELËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë